



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 25 SHTATOR 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 25.
SEPTEMBRA 2008. GODINE

SHTATOR – SEPTEMBAR
2008

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 18 shtator 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndarjen e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për armët dhe
6. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit Ad Hoc për përzgjedhjen e anëtarëve në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media.

Dnevni red

1. Usvajanje zapisnika sa plenarne sednice održane dana 18. septembra 2008. godine,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Razmatranje preporuke komisije za pravosudje i sudstvo o izboru Narodnog advokata,
4. Prvo razmatranje Nacrta - zakona o dodeljivanju odlikovanja Predsednika Republike Kosova,
5. Drugo razmatranje Nacrta-zakona o oružju, i
6. Razmatranje predloga o formiranju Ad hoc Komisije za izbor članova Odbora Nezavisne komisije za medije.

Agenda

1. Approval of the minutes of the plenary session held on 18 September 2008,
 2. Time for Parliamentary questions,
 3. Review of recommendation of the Committee for Legislation and Judicial for selection of Ombudsperson
 4. First review of the Draft Law for the Bestowing of Decorations by President of the Republic of Kosovo,
 5. Second review of the Draft Law on Weapons, and
 6. Review of the proposal for establishing the Ad Hoc Committee in selection of members for Independent Council of Committee for Media.
-

Seancën e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
Zëvendëskryeministra, ministra,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 92 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, Kryesia ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Të nderuar deputetë,
Në pikën e tretë të rendit të ditës është zgjedhja e Avokatit të Popullit, shqyrtimi në fakt i rekomandimit të Komisionit për Legjislacion, Gjyqësi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit.

Jam i vetëdijshëm për stërgjatën e procesit të zgjedhjes së Avokatit të Popullit, një çështje e përfolur shumë, me të drejtë e pa të drejtë, që shpesh e ka dëmtuar vetë autoritetin e Kuvendit. Konkursi i fundit, ndonëse pati fatin më të mirë të procedurave, sigurisht pa qenë krejt perfekt, nxori probleme të natyrave të ndryshme, duke vazhduar madje edhe me përgojime publike.

Që të mbrohet institucioni i konkursit, autoriteti i Kuvendit dhe i vet kandidatëve, ju lutem ta mbështetni propozimin tim që edhe kësaj radhe të anulohet konkursin për të pasur edhe një mbështetje më të madhe në Kushtetutë e të vendosim për rishpalljen e tij. As ju, as unë nuk ndihemi aq mirë duke vendosur kështu, për shumë rrethana objektive e bëjmë këtë zgjidhje si më të mirën të mundshme.

Jemi vonuar shumë, por le të vonohemi edhe një muaj që të jemi plotësisht korrekt edhe të harmonizuar mes nesh. Ju lutem, të më kuptoni drejt dhe të vendosim për të mirën e përbashkët dhe zgjidhjen më të lehtë të kësaj çështje.

Para se të hyjmë në procedurën e votimit, kërkoj deklarinë e shefave të grupeve parlamentare.

Sipas radhës shefi i Grupit Parlamentar i Partisë Demokratike, zoti Ramë Buja.

RAMË BUJA: Zoti Kryetar! Fjalët që desha t' i them unë, i thatë ju dhe nuk dua të komentoj fare. Ne e mbështesim propozimin tuaj.

KRYETARI: Faleminderit: Sipas radhës shefi i Grupit të Lidhjes Demokratike, Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i LDK-së mbështet kërkesën tuaj, me besimin e thellë që rishpallja e konkursit do ta funksionalizojë këtë zyrë që është shumë e rëndësishme. Ne e mirëkuptojmë kërkesën tuaj dhe e mbështesim këtë vendim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë!

Sipas radhës, shefi i Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re e mbështet kërkesën tuaj që nga rendi i ditës të hiqet kjo pikë me një kërkesë që në të ardhmen të ndërpriten praktikrat e tilla ngase zvarritja po e vë në lojë vetë krebilitetin e këtij institucioni që është shumë me rëndësi në fushën e mbrojtjes së të drejtave e lirive të njeriut. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Sipas radhës, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: I nderuar zoti Kryetar,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Ju, zoti Kryetar, e thatë se është në pyetje krebiliteti i këtij Parlamenti. Nëse është krebiliteti i këtij Parlamenti në pyetje, atëherë ky Parlament duhet ta thotë fjalën e vet ashtu si duhet dhe ju të sqaroni pse duhet të hiqet nga rendi i ditës pika për zgjedhjen e Avokatit të Popullit?

KRYETARI: Faleminderit!

AHMET ISUFI: Nuk e kam kryer. Kemi nevojë që t'i shpjegojmë edhe këtij Kuvendi, edhe popullit të Kosovës, pse ndodh kjo edhe zhagitja e procesit dhe moszgjidhja e deritashme, sepse janë në pyetje njerëzit me vlera të larta të përzgjedhurit. Dikush ose ndonjëri nga kandidatët meriton çmimin Nobel e lëre më rolin e Avokatit të Popullit.

Prandaj, ne nuk jemi për tërheqjen e kësaj pike, por jemi për ruajtjen e të gjitha vlerave për të cilat jemi të thirrur për të pasur Kosova një Parlament si duhet dhe institucionet të cilat i mbrojnë vlerat e veta dhe i avancojnë ato. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Sipas radhës, në emër të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputeti Adem Salihaj e ka fjalën.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë jam edhe anëtar i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, në fakt zëvendëskryetar i parë, kam qenë edhe në Panelin intervistues të kandidatëve.

Ne e dimë që ka qenë një odisejadë e gjatë e zgjedhjes së Avokatit të Popullit, kanë kaluar vite që ai nuk zgjidhet. Është shpallur një konkurs, nuk është zgjedhur, pastaj ky është i dyti dhe nuk po zgjidhet përsëri.

Mendoj se Komisioni me ndërgjegjeje shumë të lartë e ka kryer punën e tij dhe ka bërë përzgjedhjen e atyre që ka pasur mundësi t'i përzgjedhë.

Në fakt, as unë, as Grupi Parlamentar i LDD-së nuk e ka të qartë arsyen pse sot po ndodh kjo? Në fakt, zoti Kryetar, me këtë veprim jo që ruhet, por rrënohet autoriteti i Kuvendit, e të mos flasim për autoritetin e Avokatit të Popullit, i cili ka rënë, të themi, në fund të pusit, sepse është bërë një lojë e stërzgatur me zgjedhjen e tij.

Ne, si Grup Parlamentar, nuk e kemi të qartë pse po ndodhë kjo dhe nuk mund të pajtohemi me këtë mënyrë të veprimit rreth zgjedhjes së Avokatit të Popullit? Ne kërkojmë sqarime shtesë pse po ndodhë e gjithë kjo? Për ne është lojë me autoritetin edhe me personin e Avokatit të Popullit. Ne nuk mund të pajtohemi me kësë veprimesh, me kësë lojërash dhe shprehim bindjen tonë se, ndoshta, këtë vit nuk do të zgjidhet fare. Shpresojmë se, ndoshta, vitin e ardhshëm mund të ndodhë kjo. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+” fjalën e ka deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, predsedniče!

Evo ponovo se srećamo sa ovim problemom. I ja sam član Komisije koja je vrlo ozbiljno i profesionalno radila i na neki način privela, po nama, kraju ovaj veoma značajan posao koji smo imali. Međutim, zaista iz neobjašnjivih razloga ovo se vuče i uvek se to opravdava nekim višim ciljevima i tako dalje. Zaista, red je da Skupština kao i na Predsedništvu pre dva dana kad smo razgovarili polemiku oko ovoga, da se jednom kaže u čemu je problem, koji je razlog, zašto se ova imena tako degradiraju i naš rad toliko dovodi i razvlači. Mislim da se radi o instituciji za zaštitu i ljudskih i nacionalnih prava i dokle ćemo sve ovo odlučivati, mislim da smo ovu instituciju obezvređili.

Mi podržavamo vaš predlog da se ovo odloži, ali istovremeno apelujemo da se ubrza i konačno zna u čemu je smetnja i zašto konačno se ne vrednuje rad onih koji su toliko dugo radili na ovome. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është e Grupit Parlamentar SLS, deputeti Bojan Stojanović, e ka fjalën.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Uložene kolege poslanici,

Poštovani ministri,

U ime Samostalne liberalne stranke, tojest Poslaničkog kluba Samostalne liberalne stranke, moram reći da se potpuno slažem sa predlogom predsednika Skupštine. Želim da kažem još jednu stvar da bez obzira što se ova tačka povlači sa dnevnog reda, da se radi o glasovima da Samostalna liberalna stranka u ovoj proceduri ne bi dala podršku nijednom od kandidata, ne radi se o personalnim rešenjima nego sam smatrao da kao predstavnici Srpske zajednice imamo pravo da stim ljudima porazgovaramo i da smo raspoloženi da

priçamo i oni ne trebaju da predstavljaju samo većinsku, već i manjinsku zajednicu, ne samo Srpsu nego i ostale, tako da smo spremni da u narednu periodu damo svoje učešće, da porazgovaramo s tim ljudima i da damo podršku. Ukoliko neko smatra da podrška svih srpskih poslanika nije neophodna, bezobzira i na sledeći izbor, mi nećemo podržati takvu preporuku. Hvala!

KRYETARIT: Faleminderit!

Mendoj që sqarimin e kam dhënë, do të thotë, kërkesa ime ishte anulimi i konkursit dhe shpallja e konkursit të ri. Mendoj që duhet ta bëjmë këtë me një votim formal.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Kush është për propozimin?
Sekretaria lë t'i numërojë votat! Faleminderit! Kush është kundër?

Konstatohet se me 45 vota „për“, 15 „kundër“ dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi propozimin e Kryetarit të Parlamentit. Ju faleminderit shumë!

Ndërkohë, në pajtim me Rregullën 23.2, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka bërë propozim me shkrim për radhitjen në rend të ditës Shqyrtimin e propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për lejin e mjeteve për Ministrinë e Forcës së Sigurisë. Edhe këtë e hedhim në votim.

Kush është për? Faleminderit! A ka kundër? Nuk ka. Faleminderit! Abstenim? Nuk ka.
Do të thotë, me shumicën absolute i shtohet rendit të ditës edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Gjithashtu, ju njoftoj se me vendimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës për emërimin e deputetit Naser Osmani për anëtar të Komisionit për Buxhet dhe Financa në vend të deputetit Armend Zemaj. Kjo është si njoftim.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

- Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 18 shtator 2008

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se Procesverbali i seancës plenare të mbajtur më 18 shtator 2008, si dhe transkripti nga kjo seancë, u është shpërndarë të gjithë deputetëve.

Pyes deputetët, a kanë vërejtje në procesverbal?
Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Më fal Kryetar, se e kërkoja fjalën më herët për atë çështjen e ndërrimit në Komision për Buxhet dhe Financa, unë kërkoj që të shtyhet edhe ajo është proceduar pak me vonesë dhe të shtyhet deri sa të na kthehet Presidenti nga jashtë vendit, i kemi disa konsultime shtesë. Faleminderit!

KRYETARI: Ne e kemi marrë shkresën e Grupit Parlamentar dhe ju njoftojmë për atë. Dhe ju e dini që politikën në Parlament e bëjnë grupet parlamentare dhe ne e kemi respektuar qëndrimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Më 24.9.2008, do të thotë, ka ardhur njoftimi nga Grupi Parlamentar.

Faleminderit! Unë ju njoftova, ky ishte njoftim. Kur ta ndryshoni njoftimin, ne e respektojmë.

A ka vërejtje në procesverbal? Nëse nuk ka, atëherë konstatojmë se seanca plenare e miratoi Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 18 shtator 2008. Ju faleminderit!

Pika e dytë e rendit të ditës:

- Pyetjet parlamentare

Ju njoftoj se në bazë të Rregullës 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta. Procedimi i pyetjeve do të bëhet sipas kohës së parashtruar dhe numrit rendor të pyetjeve.

Së pari, i kemi dy pyetje nga seanca e kaluar. Deputeti Naser Rugova, pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi, ose ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala. Lus deputetin ta lexojë pyetjen.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti ministër i Ekonomisë dhe i Financave, viteve të fundit në vendin tonë janë privatizuar me dhjetëra ndërmarrje shoqërore në të cilat dikur kanë qenë të punësuar një numër i madh i punëtorëve kosovarë. Ligjërisht, këtyre punëtorëve, shumica e të cilëve kanë ngelur pa punë, u takon 20% i shumës së totalit të shitjes së ndërmarrjes në të cilën kanë punuar dhe kanë kontribuar. Kanë kaluar vite dhe ky kompensim nuk u është bërë pjesës dërmuese të këtyre punëtorëve. Ka pasur arsyeime të ndryshme, nganjëherë edhe paradoksale. Kur do t' u bëhet kompensimi i kësaj kategorie shumë të goditur të punëtorisë kosovare? Ju Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Shumë të respektuar deputetë,

Sigurisht që kjo pyetje ka të bëjë më tepër me Agjencionin e Privatizimit dhe jam i sigurt që ata një ditë do të sjellin raport për këtë çështje, por më lejoni që para jush të dalë me informatat që unë kam pasur deri në momentin kur kam qenë zëvendës drejtor i Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit. Pra, deri në fund të dhjetorit të vitit të kaluar janë shpërndarë diku rreth 15 milionë e 700 mijë euro për 20%. Është një proces i cili tani duhet të rifillojë me funksionalizimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit. Procedurat, në fakt, janë të ndërlidhura në bazë të ligjit të Rregullores 2003/3, i cili është shndërruar në ligj Ligji mbi pronën, mbi tokat. Jam i sigurt që Agjencioni Kosovar i Privatizimit, në bashkëpunim dhe në mbështetje të plotë të Qeverisë, do të gjejë rrugë më racionale dhe më të shpejta për këtë proces. Bordi i Agjencionit Kosovar të Privatizimit, sa jam i njoftuar unë, ka marrë këtë çështje me shumë seriozitet dhe jam shumë i sigurt që do të gjejmë një zgjidhje të shpejtë për zgjidhjen e këtij problemi që është trashëguar goxha gjatë.

Nuk mund t'i japë datat e sakta për këtë, sepse është kompetencë e Agjencionit Kosovar të Privatizimit dhe e Dhomës së Veçantë, pra e Dhomës Speciale e cila tani do të rifunkcionalizohet, sepse e dinë që ende nuk është transferuar si institucion për të zgjidhur problemet e Agjencionit të Privatizimit. Unë e kam besimin e plotë, ne si qeveri do të mbështesim çdo iniciativë të këtij institucioni të pavarur, qoftë në aspektin buxhetor, qoftë në aspektin teknik për të tejkaluar këtë situatë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet, a ke pyetje shtesë? Regjia, deputeti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Zoti ministër, me vite të tëra po dëgjohen përgjigje të tilla. Kushtetuta e Republikës së Kosovës s'ka muaj që ka hyrë në fuqi. Agjencioni Kosovar i Privatizimit është formuar dhe duhet ta kryejë punën e vetë. Autoritet tani në Republikën e Kosovës është Qeveria e vendit dhe, ju lutem, të merrni masa urgjente, sepse ju jeni njohës i mirë i atyre rrethanave dhe i gjithë atyre procedurave. Unë e kam një letër këtu nga sindikalistët e ish-Kombinatit Ndërtimor "Ramiz Sadiku", të cilët i janë drejtuar Kryeministrit të vendit. Kam edhe kërkesa të tjera të shumë punëtorëve, do të thotë, të cilët janë në vi të ekzistencës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës tani duhet t'i marrë masat e nevojshme që t'ju dilet në ndihmë dhe t'u paguhet munda dhe djersa që ju takon këtyre punëtorëve. Faleminderit!

KRYETARI: Ishte koment, po vazhdojmë. Deputeti Naser Rugova, pyetje për Kryeministrin ose ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotin Ahmet Shala. Lexojeni pyetjen, deputet!

NASER RUGOVA: Faleminderit!

Zoti ministër, procesi i privatizimit ka qenë një nga storiet e këqija të aferave të mëdha dhe të abuzimeve të shumta me të gjitha kategoritë e ndërmarrjeve dhe të pronave në 9 vjetët e lirisë në Kosovën e protektoratit.

Në shumë raste janë dëmtuar ekonomia e vendit, imazhi i Kosovës, por edhe ish-pronarët. Cilët do të jenë hapat e Qeverisë për zbatimin e Ligjit për Agjencionin Kosovar të Privatizimit, si dhe a do t'i rishikoni rastet e privatizimit të pronave kontestuese në të cilat raste ka shkelje flagrante të të drejtës në pronë dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: Konsideroj që nuk pajtohem me konstatimin tuaj, por dëshiroj t'ju përgjigjem lidhur me pyetjen.

Çështja e pronës është e mbrojtur me Kushtetutën e Kosovës dhe Qeveria e Kosovës e vitit 2002, në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare që kanë qenë prezentë në Kosovë deri në atë kohë, ka zgjedhur një rrugë për t'i privatizuar pronat shoqëror. Ajo rrugë ka qenë që të ndahen asetet nga borxhet e së kaluarës dhe të qiten në treg dhe të shiten. Çështja e pronës është zgjidhur që të kompensohet përmes parasë dhe jo kthimit fizik, që ka qenë dështim total i të gjitha shteteve që e kanë përzgjedhur këtë sistem. Unë

pajtohem me konceptin që të mos ketë kthim fizik, ndërsa e Drejta Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Pronës, vërtet e sanksionon për kompensim material, konform rrethanave dhe kompensimit racional dhe kompensimit real. Ajo formë është përzgjedhur nga Qeveria e Kosovës e asaj kohe, ne si Agjencion i Pavarur e kemi ekzekutuar dhe si i tillë ende është në fuqi. Në momentin kur ndërrohet ligji të cilin ju e aprovon e që ai agjencion, në fakt, ju përgjigjet juve, atëherë ndërrohen edhe procedurat e privatizimit. A ka qenë i mirë, a ka qenë i keq, janë shumë vlerësime, qofshin individuale, qofshin institucionale. Mirë është për t'i lexuar edhe ato institucionale- ndërkombëtare, të cilat kanë pasur mundësi për t'i vlerësuar edhe privatizimet në vendet e ndryshme dhe jo të lëshohem në komente individuale ose mendime ad-hoc. Sigurisht, ne jemi zotuar që t'i respektojmë konventat ndërkombëtare mbi të drejtën e pronës dhe konsideroj që me këtë proces është mbrojtur e drejta e pronës dhe të do kompensohet konform ligjit çdo e drejtë që konfirmohet nga Gjykata Speciale, e cila konsideroj që ka legjimitet ndërkombëtar në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, a ke pyetje shtesë? S'ke. Faleminderit!

Vazhdojmë me pyetjen e radhës. Deputeti Hydajet Hyseni pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala. Deputet lexoje pyetjen.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

I nderuar ministër,

Pyetja ime ka të bëjë me rastin e djegies së dokumentacionit të privatizimit. Këtë pyetje unë ia kam bërë Qeverisë dhe ministrisë përkatëse. Në mbledhjen e kaluar ministri i Brendshëm dha një sqarim që për mua ishte edhe kryesisht i mjaftueshëm. U theksua atje se nuk është djegur material i rëndësishëm për privatizimin. Megjithatë, eventualisht një përgjigje plotësuese në një pyetje plotësuese se çfarë dokumentacioni është djegur, besoj që do t'i ndihmonte sqarimit të kësaj afere dhe mjegullnajës a tymnajës, ta them, të krijuar me të: "Ku ka zjarr, ka edhe tym".

KRYETARI: Mirë, faleminderit!

Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar Hyseni,

Të nderuar deputetë,

Konsideroj që përgjigjen e saktë e ka dhënë ministri i Punëve të Brendshme dhe konsideroj që ndonjë koment më shumë do ishte vërtet i tepërt, por, gjithsesi, ajo çka ka ndodhur aty ka zgjuar interesimin edhe të mediave, edhe të gjithë të interesuarve për atë proces që e konsideroj mjaftë të rëndësishëm për të ardhmen e Kosovës.

Çdo hetim që bëhet nga organet që kanë kompetencë ligjore për ta bërë, sigurisht, do jetë valid për ekzekutim ndaj Qeverisë së Kosovës. Agjencioni i Pavarur është Agjencioni i Privatizimit, ai i përgjigjet Kuvendit, sigurisht. Një raport të tillë, sa jam i informuar, e ka sjellë në Kuvend Dino Hasanaj, kryetar i Bordit për të raportuar për gjendjen se si e ka gjetur. Në qoftë se dikush e ka bërë atë, e mbanë përgjegjësinë ai që e ka bërë. Nuk kisha dashur të lëshohem në komentime ose paragjykime se çfarë ka ndodhur, sepse do të ishin tepër, konsideroj laiike dhe jo morale. Unë, në qoftë se ka ndodhur diçka e tillë,

kam besimin e plotë në organet e rendit dhe të vendit, sikurse që e ka të njëjtin besim edhe Qeveria e Kosovës, ne si Qeveri thërrasim dhe mbështesim çdo aksion për të zbuluar dhe pasqyruar para jush çfarëdo që ka ndodhur aty. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Pyetja e radhës, deputeti Hydajet Hyseni, për ministren e Energjetikës dhe të Minierave, zonjën Justina Pula – Shiroka. Ministrija mungon. Mund ta lexoni pyetjen, deputet.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Megjithatë, dua të sqaroj këtë, meqë është hera e dytë që nuk po mund ta lexoj pyetjen, besoj për arsye të justifikueshme. Pyetja ime ka të bëjë me faktin që dimri po afron, shqetësimet e qytetarëve tanë të Prishtinës, sidomos, lidhen me mundësinë e mungesës së energjisë elektrike edhe të ngrohjes. Ka pasur një projekt që i lidhte këto dy kërkesa me idenë e lidhjes së gazifikimit me ngrohjen e Prishtinës, që do ta kursente edhe rrymën. Pyetja ka të bëjë me atë se çka po ndodh me këtë projekt dhe sa do të kursehej rryma në Prishtinë në këtë mënyrë? Besoj që herën tjetër do të marrim përgjigje. Faleminderit!

KRYETARI: Shpresojmë.

Pyetja e radhës, deputetja Myrvete Pantina, pyetje për Kryeministrin. Mund ta lexoni pyetjen, deputete.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në mungesë të Kryeministrit po ia drejtoj pyetjen ministrit Ahmet Shala, meqenëse pyetja është mjaftë urgjente dhe po shtyhet që dy seanca me radhë.

Pas privatizimit të fabrikës së lllamarinës “Llamkos” në Vushtrri, ajo pati 17 muaj punë të suksesshme sa që arriti të jetë eksportuesi më i madh në Kosovë. Sot kjo fabrikë është në shkatërrim e sipër. Fabrika ka obligime të mëdha të pakryera ndaj: Doganës, Trustit, punëtorëve, e kështu me radhë. Kanë filluar të shiten asetet e fabrikës, si dhe t’u ndërpriten kontratat punëtorëve.

Zoti ministër,

Pyetjen e parashtrojnë punëtorët e fabrikës. Janë 521 punëtorë të cilëve u kërcënohet vendi i punës. Ata pyesin: A mund të ndërmerrni diçka urgjentisht që të ndërpritet shkatërrimi i fabrikës, së paku që të mos shiten asetet e saj dhe të definohet statusi i kësaj fabrike?

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Ministër, a ke përgjigje? Urdhëro!

MINISTRI AHMET SHALA: E nderuara deputete dhe kolege Myrvete,

Edhe unë personalisht jam shumë i shqetësuar sinqerisht për fatin e asaj fabrike. Në aspektin institucional dhe juridik ajo qëndron nën kompetencën e Agjencionit Kosovar të Privatizimit. Në bazë të informacioneve që unë kam dhe kam pasur derisa kam qenë zëvendësudrejtor, është e vërtetë që investitori nuk i ka kryer obligimet konform kontratës dhe obligimeve që i ka marrë gjatë tenderimit. Është në kompetencën dhe unë dua ta thërras tani publikisht dhe do t’ia bëjë me shkrim që sot ose nesër kurdo që të kem mundësi kohore për ta përpiluar një letër kryetarit të Bordit të Agjencionit Kosovar të

Mirëbesimit që konform kompetencave dhe mundësive juridike të veprojë ndaj pronarit, i cili ka pasur obligime dhe nuk i ka shlyer. Kjo është mundësia jonë juridike, kjo është mundësia jonë institucionale. Unë absolutisht i bashkëngjitem shqetësimit dhe do të kërkoj, si ministër i Ekonomisë dhe Financave, ndaj Bordit të AKP, përkatësisht Agjencionit Kosovar të Privatizimit që të marrë masa konform kompetencave dhe mundësive ligjore që i kanë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputete, a ke pyetje shtesë? Urdhëro! Deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Zoti ministër,

Agjencioni Kosovar i Privatizimit veç i ka qe disa muaj kompetencat, pse nuk vepron?

KRYETARI: Urdhëro, ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: Është mirë edhe ju t' i thirrni ata këtu se ju përgjigjen juve –Kuvendit, konsideroj. Por, ne kërkojmë dhe e mbështesim çdo veprim dhe kërkoj publikisht, po ashtu, nga Bordi që të veprojë konform kompetencave dhe ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Deputete bëje pyetjen.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit!

Ditëve të fundit është folur shumë lidhur me pagat e personaliteteve më të larta të Republikës së Kosovës, gjë që ka shkaktuar reagime të mëdha në opinion, të cilat reagime, natyrisht, që janë normale për rrethanat aktuale ekonomike të Kosovës.

Zoti ministër, cilat institucione dhe organizata publike në Kosovë japin paga që janë më të larta se pagat e personaliteteve më të larta në Kosovë dhe sa janë ato?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: E nderuara kolege, profesoreshe dhe deputete, Myrvete, Pyetjen tuaj e keni bërë për cilat institucione publike dhe sinqerisht nuk isha i sigurt a e ke bërë për institucionet shtetërore apo për ndërmarrjet publike? Në qoftë se ke bërë për ndërmarrjet publike, është temë tjetër, nëse e ke bërë për institucionet publike, atëherë përgjigjen sigurisht do ta japë ministri Arsim Bajrami, sepse ai është përgjegjës për rrogat e stafit civil, përkatësisht institucioneve të Qeverisë.

Ndërmarrjet publike janë subjekte ekonomike të pavarura, pra janë korporata me kapital publik, ndërmarrje aksionare me kapital publik ku bordi i tyre përcakton konform mundësive të tyre financiare dhe konform mundësive për të gjetur njerëz kompetentë për ta udhëhequr ndërmarrjen edhe nivelet e pagave.

Ka teori dhe praktika të ndryshme se a duhet shteti t'i kontrollojë në qoftë se ato janë ende ndërmarrje publike, pagat e drejtorëve, përkatësisht të menaxherëve të ndërmarrjeve publike apo duhet t'ia lë tregut për ta përzgjedhur atë? Kjo është një çështje për t'u

debatuar dhe personalisht konsideroj që vizioni jonë është për t'i privatizuar ose dhënë me koncesion këto ndërmarrje dhe ajo do të jetë zgjedhja fundamentale dhe strategjike. Çdo përpjekje për të kontrolluar, mbase, mund të shkaktojë turbulenca menaxheriale. Rrogat e ndërmarrjeve publike, vërtet, i përcakton Bordi i ndërmarrjeve publike dhe Qeveria e Kosovës mund të sugjerojë, por nuk mund të diktojë. Nuk jemi shtet etatist dhe nuk dëshirojmë ta ndërtojmë atë sistem. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shtesë?
Regjia, fjalën deputetes Myrvete.

MYRVETE PANTINA: Zoti ministër,
A është në rregull që ndërmarrjet publike, të cilat pjesërisht financohen edhe nga Buxheti i Republikës së Kosovës, të japin paga të nivelit të personalitetit më të larta shtetërore ose edhe më të larta?

KRYETARI: Ministër, a ke përgjigje?

MINISTRI AHMET SHALA: Ka pasur ndërmarrje në botë që kanë qenë në fazën e bankrotimit dhe të likuidimit nga buxheti i shtetit, ka pasur derdhje financiare të mëdha, por menaxherët e kanë marrë rrogën e menaxherëve, konform lëvizjeve të punës në treg. Thashë, ekzistojnë ide dhe mundësi të ndryshme. Ne mund edhe të ecim në atë rrugë, por efektet konsideroj që janë më të mira dhe afatgjate që ato t'i privatizojmë, përkatësisht t'i japim me koncesion, sidomos tani kur Qeveria e Kosovës është absolutisht e përcaktuar për ta privatizuar KEK-un. Do ishte një ushtrim jo i mençur, një aktivitet jo i mençur për të hyrë dhe debatuar e humbur kohë për ato çështje.

Të njëjtën veprim jemi duke bërë me Aeroportin dhe jemi duke përgatitur për koncesion dhe besoj që brenda një viti do ta japim me koncesion dhe pastaj koncesioneri vetë do të gjejë mundësi dhe përzgjedhje më të mirë, qoftë menaxheriale, qoftë zgjidhje tjera komerciale, kështu që jemi të përkushtuar që sa më shpejtë të heqim në këtë strategji dhe të mos të humbim kohë me menaxhimin e ndërmarrjeve publike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Po mendoj që pyetja e deputetes ishte- Cilat institucione dhe organizata publike në Kosovë japin paga që janë më të larta se pagat e personaliteteve më të larta të Kosovës dhe sa janë ato? Pra, këtë përgjigje nuk e dhatë, shpresojmë që Qeveria do ta japë ...

Tash kalojmë në pyetjen tjetër. Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për Kryeministrin, Kryeministri nuk është këtu. A doni ta bëni pyetjen deputete, ndoshta përgjigjen zëvendëskryeministrat.
Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Zoti Kryetar,
Shpreh zhgënjimin e thellë që s'është Kryeministri këtu, është një papërgjegjësi e plotë për pyetjen të cilën ia kam bërë dhe nuk jam e sigurt a do të përgjigjet zëvendëskryeministri. Nuk mund t'ia bëjë pyetjen, nëse nuk e di a do të përgjigjet zëvendëskryeministri, prandaj le të deklarohet zëvendëskryeministri.

KRYETARI. Jo! I ke edhe tri pyetje të tjera. Kalojmë te pyetja për ministrin e Shëndetësisë. Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi.

GJYLNAZE SYLA: Në Kosovë është gjithnjë e më shumë në rritje numri i rasteve të sëmundjeve malinje dhe është e nevojshme që sa më shpejtë të fillohet me luftimin e sëmundjeve malinje, prandaj, është e domosdoshme që Instituti i Onkologjisë në Prishtinë ta fillojë punën sa më parë.

Zoti ministër ma ka sjellë një shkresë me një sqarim lidhur me çështjen e Institutit, por e cila nuk e ka dhënë përgjigjen në pyetjen që ia kam parashtruar. Prandaj, pyes ministrin:- Pse nuk po vihet në funksion Instituti i Onkologjisë në Prishtinë? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ALUSH GASHI: I nderuar zoti Kryetar,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Shumë të respektuar kolegë deputetë,

Zonja deputete, pyetja juaj është një ndër pyetjet e preokupimit më të rëndësishme të shëndetësisë së vendit tonë që nga vitet 1974 – 75 kur janë bërë përpjekje që të fillojë ekzekutimi i Laboratorit të Onkologjisë dhe në atë kohë janë bërë përpjekje që të sigurohet një gama kamerë dhe të jetë një hapësirë. Kjo çështje është riaktualizuar para katër vjetësh dhe, për shkak të korrektësisë, unë jua kam sjellë një pjesë të dokumentacionit, i cili ju ofron mjaftë të dhëna që të dini se si qëndron kjo çështje. Për shkak të deputetëve të tjerë, më lejoni t’ju them që kjo është një prej pjesëve të cilat është keq menaxhuar në Ministrinë e Shëndetësisë. Në vitin 2004, së pari është blerë aparatura, pastaj ka filluar ndërtimi i objektit, por ai ndërtim i objektit nuk është punuar sipas standardeve, trashësia e murit, përmbajtja e murit ka qenë në kundërshtim me standardet për këtë lëmi dhe që në fillimi i këtij viti jemi marrë intenzivisht me te dhe Simensi, i cili e ka aparaturën e blerë që katër vite dhe e cila ndodhet në Kosovë, i ka dhënë sugjerimet e veta. Pra, kontraktuesit presim që këto ditë ta thonë fjalën e fundit se a ka arritur të bëhet përmirësimi sipas kriterëve të Simensit dhe ne shpresojmë që gjatë këtij viti do të funksionalizohet, do të fillojë Onkologjia, sepse për Onkologji dhe Kardiokirurgji harxhohen më së shumti mjete jashtë vendit. Sa për korrektësi, ju njoftoj se kjo është një prej dosjeve që policia për krime të rënda është duke hetuar tashmë 4 – 5 muaj. Për shkak të korrektësisë për hetime, unë nuk do të isha marrë me emra dhe me detaje, por është preokupim dhe shpresojmë që gjatë këtij viti do të fillojë Onkologjia.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputete, ke pyetje shtesë?

GJYLNAZE SYLA: Zoti ministër,
Nuk funksionalizohet Instituti duke shpresuar. Unë dëshiroj të dëgjoj nga ju saktë, cilën ditë do të fillojë punën Instituti? A e dini sa i kushton buxhetit një familje trajtimi jashtë vendit?

MINISTRI ALUSH GASHI: Zonja deputete,

Unë e kuptoj shqetësimin tuaj, këtë shqetësim unë e kam afro 30 vjet dhe ju garantoj se ajo që s'është arritur prej vitit 1974, kur është provuar të ndërtohet Bunkeri i Kobaltit, është blerë gama kamera, në vitin 2004 është gabuar, është keqmenaxhuar, së pari është blerë aparatura, pastaj është provuar të bëhet projekti, të fillojë ndërtimi dhe në këtë ka shumë shkelje dhe në këtë janë të lidhur shumë emra të respektuar të institucioneve tona. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje sërish për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi. Deputete, bëjeni pyetjen!

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Për trajtimin e të sëmurëve jashtë Kosovës Ministria e Shëndetësisë ndanë buxhetin në kuadër të programit për trajtim jashtë vendit. Mirëpo, pas kthimit në Kosovë të sëmurëve të trajtuar jashtë, duhet të vlerësohet sukcesi i këtyre trajtimeve.

Prandaj, pyes ministrin Alush Gashi: A ka Ministria e Shëndetësisë statistika të sakta për nivelin e suksesit të trajtimeve të pacientëve jashtë Kosovës dhe cili është rezultati?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju faleminderit, shumë!

Siç e thatë ju, me një udhëzim administrativ që nga viti 2003 janë përcaktuar kushtet për trajtim jashtë vendit. Nën një, rekomandimi bëhet nga mjeku, ai shkon në Komisionin e Klinikës, Komisioni i Klinikës e udhëzon në Komisionin mjekësor për vlerësim, pas atij komisioni shkon te Bordi ekzekutiv, me zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë, të Fakultetit të Mjekësisë dhe të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave dhe këta ia bëjnë prezantimin ministrit të Shëndetësisë deri në 3000 euro, nëse është mbi 3000 euro ministri i Shëndetësisë së bashku me atë të Ekonomisë dhe të Financave e nënshkruajnë deri në 30 mijë euro.

Me udhëzimin administrim është e përcaktuar që pas kthimit pacienti është i obliguar ta japë një raport lidhur me trajtimin. Dhe, në ditët e para të këtij mandati unë e kam vërejtur që ato raporte mungojnë. Për shkak të asaj, në Qeveri, e në veçanti me ministrin e Ekonomisë dhe të Financave kemi marrë vendim që për të gjithë ata që shkojnë në trajtim jashtë vendit, ne ta rezervojmë të drejtën që një 10% të shumës ta ndalim deri në kthim të raportit dhe të përmbylljes së dosjeve. M'u për atë, një analizë e saktë e suksesit, por jo vetëm e suksesit, por edhe një raport i saktë financiar të përmbylljes së këtyre dosjeve që nga viti 2003 në tërësi është vështirë këtu që ekziston, diku krejt 100 dosje nga aspekti financiar nuk janë të përmbyllura, ndërsa analiza profesionale- shkencore deri në këto momente nuk ekziston.

Unë së bashku me ministrin e Ekonomisë dhe të Financave e kemi marrë këtë vendim, aspektin financiar do ta sigurojmë dhe do të kërkojmë nga ekipi i ekspertëve të fushës përkatëse që në mënyrë periodike ta bëjnë analizën e suksesit të trajtimit. Por, shpresoj se zgjidhja nuk është në trajtimin jashtë vendit. Ne do të hapim tender ndërkombëtarë pas miratimit të Ligjit për partneritet publiko – privat që ta themelojmë Kardiokirurgjinë në Kosovë, që Onkologjia të jetë e suksesshme. Gjatë këtij viti nuk kemi raste që dërgohen

për Gjinekologji apo për Dermatologji, apo për çështje tjera të cilat janë dërguar më parë, që kanë qenë në kundërshtim të plotë me udhëzimin administrativ.

Prandaj, shpresoj që përgjigjen e saktë në pyetjen tuaj sa i përket analizës do ta kemi në një fazë tjetër.

KYETARI: Faleminderit!

Deputete, a ke pyetje shtesë? Regjia fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Zoti ministër, i çmoj përpjekjet tuaja, por nuk kishte të dhëna për rezultate. Tani i keni 2 milionë euro më shumë këtë vit për shërimin jashtë vendit. A keni hapur tender ndërkombëtarë për të bërë përzgjedhjen e institucioneve shëndetësore jashtë Kosovës në bazë të konkurrencës dhe në interesin më të mirë të pacientëve?

KRYETARI: Ministër, vazhdoje përgjigjen!

MINISTRI ALUSH GASHI: Ne me buxhetin shtesë jemi duke i zgjidhur problemet e vitit 2003, 2004, 2005, 2006, 2007. Në vitin 2008 nuk kemi ngecje dhe për të gjitha këto vite në bazë të një udhëzimi administrativ dhe të marrëveshjes që ende është në fuqi mes Ministrisë së Shëndetësisë të vendit tonë dhe të Turqisë, atje ekziston një mirëkuptim që në institucionet publike të ketë çmime më të përshtatshme.

Ne, për vitin e ardhshëm, nëse nuk kemi sukses në tenderin për partneritet publiko-privat që këtu të hapet Kardiokirurgjia, atëherë marrim në konsideratë këtë çka ju thoni. Kemi biseduar me numrin më të madh të përfaqësive këtu dhe ne do të bëjmë përpjekje që ta kemi një tender ndërkombëtar, që të jenë çmime kompetitive, por praktika ka treguar se qytetarët tanë lirinë e lëvizjes nuk e kanë të garantuar. Një pacient të cilin t'i e dërgon, bie fjala në Turqi, ata e garantojnë një vizë, nëse është ai mjekim me 5000 euro, por për të shkuar në Zvicër, bie fjala, duhet pasur një garraci bankare së paku 50.000 euro. E njëjta gjë vlen edhe për vende të tjera të Shengenit, andaj kjo ka qenë ndoshta një prej arsyeve që deri më tani trajtimi jashtë vendit ka shkuar në këtë mënyrë si ka shkuar. Unë për veten time jam i angazhuar që trajtimi të bëhet në vend, nëse do të jemi të shtyrë që të vazhdohet trajtimi jashtë vendit, ne do të shpallim tender.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputetja, Gjylnaze Syla, pyetje për ministrin e Ekonomisë e Financave, zotin Ahmet Shala.

Deputete, bëje pyetjen!

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Për çështjen e maunave me acid disulfurik, ministri Ahmet Shala, gjegjësisht Qeveria e Kosovës pati suspenduar drejtorin e përgjithshëm të Doganave, zotin Naim Huruglica. Pastaj, zoti Ahmet Shala e ka tërhequr vendimin.

Zoti ministër, pse e keni suspenduar përkohësisht drejtorin e Doganave, zotin Naim Huruglica dhe pastaj e keni anuluar vendimin? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: E nderuara deputete, Edhe ju, edhe institucionet vendore, qytetarët e Kosovës jeni të njoftuar, përkatësisht keni qenë spektatorë të ngjarjeve sa i përket acidit disulfurik, i cili ka shkaktuar shumë probleme mjedisore dhe me kërkesë dhe shqyrtim të Qeverisë për këtë çështje, konform kompetencave që kam pasur në bazë të ligjit, kam kërkuar të bëhet suspendimi i përkohshëm i drejtorit të Doganave derisa të shqyrtohet involvimi eventual ose përgjegjësia e tij direkte ligjore ndaj rastit në fjalë. Është formuar Komisioni i përbërë nga Ministria e Ekonomisë dhe të Financave dhe Ministria e Mjedisit, i cili në mënyrë mjaft profesionale dhe neutrale e ka shqyrtuar lëndën, ka shqyrtuar implikimin eventual dhe përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të drejtorit, zotit Huruglica. Në bazë të konstatimeve dhe të gjetjeve të këtij Komisioni, del që ka pasur përgjegjësi menaxheriale, mbase neglizhencë menaxheriale, por nuk ka pasur përgjegjësi juridike të drejtpërdrejtë të drejtorit të Doganave dhe, natyrisht, në çdo vend, në çdo shoqëri kur ngrihet një çfarëdo qoftë procedure, një komision ndaj një personi të caktuar, sigurisht që do të duhet të merret masa e përkohshme e suspendimit, me qëllim të lejimit të lirshëm të hulumtimit të rastit dhe në qoftë se ai komision i pavarur ka sjellë një konstatim se nuk ka pasur involvim të drejtpërdrejtë, zoti Naim Huruglica është kthye në detyrën e njëjtë që ka pasur, në të njëjta kompetenca, me një vërejtje mbase interne për syçelëti dhe mbrojtje më të mirë të qytetarëve të Kosovës, është kthyer në punë më 15 shtator dhe ai vazhdon të kryejë detyrën e vet. Konsideroj që kjo është një praktikë e zakonshme në vendet ku ka vlera të përgjegjësiave dhe ka procedura të qarta ndaj këtyre rasteve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet, a ke pyetje shtesë?

Regjia, fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Është praktikë e zakonshme, zoti ministër, ku ka ICO. A pranoni se keni gabuar dhe, kam një pyetje: Kush e ka porositur vajin disulfurik, nëse e dini?

KRYETARI: Zoti ministër, ke përgjigje? Urdhëro!

MINISTRI AHMET SHALA: Jo, konsideroj që kam vepruar konform kërkesës së Qeverisë, konform ligjit dhe konform kompetencave që kam dhe absolutisht konsideroj që as institucioni, përkundrazi unë do të jem në të njëjtën linjë për çdo rast në qoftë se eventalisht paraqitet në institucionin ku unë kam kompetenca për të shqyrtuar dhe konsideroj që vetë fakti që është kthyer, nuk ka pasur paragjykime as politike, as paragjykime për fajësinë. Në momentin kur një komision i pavarur ka konstatuar, ne e kemi kthyer.

Sa i përket asaj se kush e ka porositur vajin disulfurik, sinqerisht detajet as që më kanë interesuar, sepse tregtohet dhe veprohet me qindra- mijëra mallra në Kosovë dhe po të lëshohem në ato detaje, atëherë nuk do të kem kohë të merrem me punë tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputete, a ke pyetje shtesë? Kjo ishte pyetja shtesë. Mirë, faleminderit!

Pyetja e radhës është përsëri e deputetes Gjylnaze Syla, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Deputete, bëje pyetjen e re!

GJYLNAZE SYLA: Jam e bindur që ministri do të jetë i kënaqur të përgjigjet. Qeveria ka marrë vendim për mosndëshkimin e borxhlinjve që nuk i kanë paguar borxhet ATK-së. Pra, Qeveria ka vendosur t'ua falë borxhet atyre kompanive që kanë fajin më të madh për evazionin fiskal në Kosovë. Me këtë vendim janë shpërblyer ata që u ikin tatimeve. Kjo shtron dilemën dhe është e padrejtë ndaj atyre që i kanë paguar, prandaj ju pyes, zoti ministër, sa do t'i stimulojë ky vendim kompanitë e ndershme që në të ardhmen t'i paguajnë dënimet, duke marrë parasysh se me këtë vendim shpërblehen ata që u ikin tatimeve?

KRYETARI: Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit!

Për pyetjen mbase nuk falënderohet por, gjithsesi, faleminderit për kujdesin. Po më vjen shumë keq që qe disa herë po përpiqemi të sqarojmë dhe mbase ose nuk po dëgjohemi, ose është mungesa jonë për të sqaruar. Më lejoni të sqaroj. Nuk ka falje borxhesh, ka pezullim të ndëshkimeve super të larta që i kanë stërngarkuar dhe i kanë lodhur, konsideroj, bizneset kosovare. 241 milionë euro janë mbledhur borxhe, ndëshkime dhe kamata. Prej 241 milionë euro, nga viti 2001 po flas, 107 milionë euro janë borxhe, pra, është kryegjësja, ndëshkime janë 59 milionë e 720 mijë euro dhe penale janë 70 milionë e 983 mijë euro. Çka kemi bërë ne? Thjeshtë, për t'i dhënë shansin dhe disiplinuar dhe për t'iu dhënë shans për të vepruar ata të cilët, vërtet, për një apo tjetër arsye nuk kanë mundur që për shkak të stërngarkimeve të mëdha të pezullojnë vetëm ndëshkimin, as kamatën, as kryegjënë. Pra, ne u kemi dhënë shans që ai ndërmarrës, ajo ndërmarrje, e cila hynë në marrëveshje me Administratën Tatimore deri më 31 dhjetor të këtij viti dhe zotohet së do ta paguajë brenda vitit nga momenti i nënshkrimit të kontratës- kryegjënë dhe penalet, pra 107 milion euro në tërësi dhe 70 milion euro tjera që bëjnë të gjitha 180 milionë euro, do të lirohet nga ndëshkimi që ka qenë në tërësi 59 milionë euro. Kjo në asnjë mënyrë nuk pretendon dhe nuk fal borxhet, por bën një shans një ofrim dore atyre që donë të respektojnë ligjin. Konsiderojmë që me këtë më shumë do të përfitojnë taksapaguesit e Kosovës. Unë kam qenë në kontakt me të gjitha assacionet e biznesit, me Odën Ekonomike, me Odën Amerikane, me Aleancën e Biznesit dhe në dialog të përbashkët kemi ardhur në përfundim që kjo është zgjidhja më e mirë e mundshme. Ndoshta nuk është perfekte, por më e keqja e mundshme do të ishte të rrimë duarkryq e të mos bëjmë asgjë. Kjo nuk i amnistion asnjë dhe pas 1 janarit të këtij viti ata që nuk hynë në veprim dhe ju lus që të procedojmë me dy ligje të cilat janë në proces, Ligji për procedurat e Administratës Tatimore dhe TVSH-në, ne do të kemi edhe masa represive ndaj atyre dhe konfiskim të mallit dhe konfiskim të pasurisë.

Andaj, ju thërras përmes kësaj foltoreje të gjithë juve që të përkrahni këtë aksion në mënyrë që të disiplinohet biznesi dhe të mbushim buxhetin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër për sqarimet!

Deputete, a ke pyetje shtesë?

Regjia, fjala e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Zoti ministër, patjetër që të gjithë jemi të interesuar që përparojë biznesi, por është e padrejtë në qoftë se dikush përfiton e të tjerët paguajnë me kohë.

Pyetja ime është: - Kush janë përfituesit më të mëdhenj nga shlyerja e këtyre borxheve? Cilat kompani dhe shifrat, sa kanë përfituar? Pse nuk keni bërë vendimin, për shembull, deri në 50.000 euro dhe mbi 50.000 euro, pastaj duhet paguar. A mund të na i numëroni kompanitë më të mëdha përfituese?

KRYETARI: Ministër, ke përgjigje?

MINISTRI AHTMET SHALA: Mbase këtë pyetje është dashur për t'ua shtruar edhe qeverive tjera, pse s'kanë marrë veprime për t'i inkasuar borxhet? Ne konsiderojmë që kemi zgjedhur rrugën më të mirë për të ndihmuar biznesin dhe për të mbushur arkën e shtetit. Unë nuk dua të lëshohem me emra, sepse nuk kemi as të drejtë të lëshohemi me emra dhe nuk dua të lëshohem me emra dhe nuk është qëllimi im të lëshohem me emra. Unë dua të jap strukturën e ndërmarrjeve. 107 milionë euro i kanë bizneset individuale, sigurisht që do t'i keni të gjitha listat dhe do të dispozitohet në Webseit të ATK-së çdo veprim tonin, 107 milionë euro janë borxhet e bizneseve individuale, përkatësisht 44,5%, ndërsa te kompanitë me aksione të përbashkëta borxhi është 42 milionë. Pra, këto të dyja janë përafërsisht 151 milionë euro vetëm borxhet e firmave individuale, që është një kompani, e ka një emër, e ka një person dhe ka biznes individual. Ndërsa, të gjitha të tjerat janë 17%, 5%, 8% e të tjera.

Edhe njëherë dua të përsëris dhe, mbase, nuk është e tepërt të thuhet se asnjëherë nuk kemi bërë falje të borxheve, kemi bërë pezullim të përkohshëm deri me 31 dhjetor të ndëshkimeve, vetëm të ndëshkimeve, as të kryegjësë, as të borxhit, as të kamatës. Mbesin 180 milionë euro në qoftë se dëshirohet të hyhet në marrëveshje me ATK-në. 150 ndërmarrje deri më tani brenda një jave kanë ardhur te ATK-ja dhe kanë paraqitur kërkesat për nënshkrim kontrate dhe programim të shlyerjes së borxheve. Për këtë, konsideroj se duhet shikuar pasqyrën mirë, jo vetëm eventualisht spekulime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit ministër! Pyetja e radhës është nga deputetja Suzan Novobrdaliu për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi. Deputetja është këtu dhe mund ta bëjë pyetjen.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritje për të gjithë,

Sipas raportit të auditimit, parregullsitë e gjetura në Ministrinë e Shëndetësisë deri më 31 dhjetor 2007 janë të shumta. Rreth 60% të produkteve medicinale, që qarkullojnë në tregun tonë, janë ilegale dhe të pa licencuara nga AKPM-ja.

Po ashtu, që nga viti 2005 janë të punësuar 10 punëtorë me kontratë, që marrin pagë për të punuar në laborator për kontrollimin e cilësisë së produkteve medicinale, kurse laboratori ende nuk është në funksion.

QKUK ka shpenzuar për blerjen e aparatit të CT-tomografisë shumë prej 689.950 euro, i cili aparat nuk është futur në funksion fare.

Janë evidente mungesa e kontrollit rreth prokurimit dhe shumë parregullsi tjera. Pas emërimit tuaj si ministër, pse nuk keni ndërmarrë asnjë veprim konkret në lidhje me këto dukuri skandaloze brenda Ministrisë që e drejtoni?

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju falënderoj për pyetjen! Auditimi për vitin 2007 dhe për vitet e tjera, është publik dhe, fatkeqësisht, ka evidentuar shumë parregullsi. Sa i përket çështjes së barnave, që ju thoni ashtu siç është në auditim 60%, unë mund t'ju garantoj se në këtë drejtim kemi arritur suksese të konsiderueshme.

Nën një, është vërejtur menjëherë se një prej arsyeve pse ekziston kjo përqindje aq e madhe e barnave, që mund të cilësohen si hyrje ilegale, është se me udhëzimin aktual të asaj kohe ka pasur shumë kërkesa, ka pasur shumë vështirësi dhe ne e kemi ndërruar udhëzimin administrativ, i cili ka thjeshtësuar procedurat, që do të thotë se nëse prodhuesit e Bashkimit Evropian e kanë një produkt farmaceutik në më shumë se dy vende të Bashkimit Evropian, ai produkt mund të hyjë në Kosovë. Po ashtu, për Mbretërinë e Bashkuar, për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për Kanada, Izrael dhe Japoni, dhe kjo e ka lehtësuar punën.

Nën dy, me situatën që ju e përshkruani, ka qenë një konflikt i interesit sa i përket Inspektoratit të Farmacisë që të jetë në kuadër të Agjencisë Kosovare për Produkte medicinale dhe atë konflikt interesi e kemi evituar. E kemi sjellë Inspektoratin e farmacisë në Ministri të Shëndetësisë dhe që nga ajo kohë, do të thotë, deri më 15 shtator të vitit 2008 i kemi 808 inspektime që iu kanë bërë farmacive anekënd vendit tonë dhe një numër bukur i madh ndëshkimeve financiare në bazë të ligjit është shqiptuar.

Jemi në dialog permanent me Shoqatën e Farmacistëve dhe të Distributorëve, sepse e kemi një problem praktik. Qytetarët që janë qytetarë të Kosovës, janë edhe qytetarë, bie fjala, të Maqedonisë apo janë banorë të Luginës së Preshevës dhe ata, si qytetarë të Kosovës, e kanë të regjistruar barnatoren, por gjatë inspektimeve ata nuk gjenden aty, prandaj është marrë vendim që asnjë barnatore nuk mund të funksionojë

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shtesë? Regjia, deputetja Suzan Novobrdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBRDALIU: Po, zoti Kryetar, kam pyetje shtesë.

Faleminderit!

Zotëri ministër, ju u përgjigjët vetëm sa u përket barnave, mirëpo unë konsideroj që në Ministrinë tuaj gjendja është çfarë është, është para kolapsit dhe ju keni treguar pafuqi për vendosjen e rregullit dhe të ligjit në Ministrinë tuaj. Çka më tutje?

KRYETARI: Vazhdoje tash përgjigjen, ministër!

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju faleminderit!

Në pyetjen lidhur me fuqinë dhe pafuqinë, unë nuk kisha për t'u përgjigjur. Sa i përket konstatimit tuaj se laboratorit në Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale nuk

funksionon, nuk është e vërtetë. Ai laborator funksionon që nga prilli i këtij viti dhe konstatimi juaj nuk qëndron. Sa i përket aparaturës së blerë nga Qendra Klinike Universitare me kohë, ai konstatim ekziston. Përgjigja lidhur me këtë çështje është dhënë nga kjo foltore shumë herë. Dhe, sa u përket raporteve të auditimit për vitin 2007, ne funksionojmë në bazë të ligjeve në fuqi dhe të gjitha institucionet e kanë obligimin e vet që deri më 1 tetor të japin përgjigje për rekomandimet që kanë obligim për veprimet që do t'i ndërmarrim dhe ju garantoj se Ministria e Shëndetësisë do të veprojë në përputhshmëri me ligjin.

Duke u kthyer te fuqia, unë ju garantoj një punë dhe do ta zbatojmë ligjin, por jam i sigurt që unë s'jam kryeprokuror i Kosovës dhe, fatmirësisht, gjyqësia është e ndarë prej nesh dhe e dinë institucionet vendore dhe ndërkombëtare se një prej problemeve më të mëdha të vendit tonë është gjyqësia.

Unë ju ftoj si Kuvend që të ndihmoni që njerëzit që e kanë shkelur ligjin, të përgjigjen para ligjit. Nëse kemi problem në shëndetësi, ne kemi edhe problem se gjyqësia nuk është duke vepruar ende. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe pse gjyqësia nuk është çështje e Ministrisë së Shëndetësisë, vazhdojmë me pyetjen e radhës. Deputeti Naim Rustemi, pyetje për ministrin Mahir Yagcillar. Urdhëro, deputet, bëje pyetjen! Kjo është pyetja e fundit për këtë seancë.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, Kryetar!

I nderuar ministër,

Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, me datën 26 gusht ka kontraktuar me Kompaninë Ces Environmental Services për ambalazhimin dhe largimin e materialeve helmuese nga Kosova, që do të paguhet nga xhepat e qytetarëve të Kosovës. Përmbajtja e këtij materiali helmues, është thënë se është acid disulfurik. Ky material është sjellë në Mitrovicë pasi që ka kaluar komunën e Kaçanikut, Ferizajt, Prishtinës, Vushtrisë, është ndalur në Mitrovicë. Kanë qenë edhe dy komuna më tutje dhe nuk është dërguar në Zveçan, atje ku janë furrat e larta, që janë në përdorim, janë më të sotifiskuara dhe paraqesin më pak rrezik për helmimin eventual të qytetarëve.

Qytetarët e Mitrovicës protestuan me javë të tëra dhe këto protesta u ndërprejnë duke përdorur dhunë.

Pyetja: -A mund të tregohet saktë se çfarë është përbërja kimike e këtij materiali helmues? A mund të komunikohet se kush janë fajtorët për importin e këtij materiali që i helmoi dhe po vazhdon t'i helmojë...?

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: E harxhove kohën, mendoj që ministri e ka të qartë pyetjen. Urdhëroni, ministër!

MAHIR YAGCILAR: Po, i nderuar Kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Zoti Rrustemi,

Materia e ngarkuar në tri maunat, të cilët aktualisht ndodhen në Mitrovicë, me analizë është konstatuar si një lloj lëngu dhe se kanë përbërje të disulfidit dhe hidrokarbonatit. Këtë e kanë konstatuar përmes disa analizave. Analizat janë bërë dy herë në INKOS, pastaj në Shëndetin Publik të Maqedonisë, e gjithashtu me analiza në Greqi dhe në fund analiza ka bërë edhe KFOR-i, që kanë treguar se është një materie ose një lëng, i cili ka një përbërje të disulfidit dhe hidrokarbonatit. Disulfidet janë substancë që avullohen lehtë, me toksicitet të mesëm, të dëmshëm për mjedisin dhe gjatë frymëmarrjes shkaktojnë marramendje, vjellje dhe kokëdhembje. Por, problemi është se materiet nuk janë të paketuara sipas standardeve. Kështu, me zgjedhjen e kompanisë, e cila do ta transportojë, do të bëhet një paketim me standardet ndërkombëtare me kontejnerët ISO dhe do të transportohet jashtë Kosovës. Mallin në Kosovë e ka sjellë Ndërmarrja” Prizmaoil” nga Prizreni dhe sigurisht destinacioni nuk ka qenë në Mitrovicë, por në atë kohë ka qenë një komision i përbërë nga Zyra e Kryeministrit, Ministrisë së Transportit, Ministria e Mjedisit, Ministria e Tregtisë, Departamenti i Emergjencës, TMK-ja dhe KFOR-i, që kanë vendosur të bëhet ashtu. Por, besojmë që së shpejti, brenda javës ose më së shumti brenda dy javësh në vijim, kjo materie do të transportohet jashtë Kosovës, në SHBA për asgjësim, sepse në Kosovë, sikur është konstatuar, nuk ekzistojnë mundësitë ose impiantet për asgjësimin e kësaj lloji materie.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputet, a ke pyetje shtesë? Urdhëro, bëje pyetjen!

NAIM RRUSTEMI: Nga përgjigja e ministrit nuk u tha pse u zgjodh Mitrovica. Unë do t’ia bëj një pyetje: - A u zgjodh Mitrovica duke pasur parasysh se qytetarët kanë qenë të helmuar me dekada, për 9 vjet me radhë helmohen nga lotsjellësi. Pra, është pyetja: - Pse pikërisht Mitrovica?

KRYETARI: Të gjithë e dëgjuam, ministri e dha përgjigjen se kush e ka bërë përzgjedhjen.

Vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës. Është pika e katërt, e cila tash bëhet si pika e tretë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndarjen e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës

Në bazë të Rregullës 35 pika 1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj zëvendëskryeministrin, zotin Ramë Manaj, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë projektligjin.

ZËVENDESKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Qëllimi i Projektligjit për ndarjen e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës është rregullimi ligjor i dhënies së dekoratave nga Presidenti, që u ndahen qytetarëve të Kosovës, qytetarëve të huaj, si dhe personave juridikë që shquhen për merita të veçanta ndaj Republikës së Kosovës dhe interesave kombëtare të vendit.

Me këtë projektligj synohet, dhe për herë të parë në Kosovë rregullohet në detaje dhënia e dekoratave nga Presidenti i vendit që u jepen individëve dhe institucioneve.

Projektligji për ndarjen e dekoratave nga Presidenti është përgatitur nga Zyra për Shërbime të Ndhmës Juridike pranë Zyrës së Kryeministrit, në bashkëpunim me Zyrën e Presidentit dhe është i harmonizuar me ligje të BE-së, standardet e përcaktuara sipas *aquis communautaire*.

Me miratimin e këtij projektligji, duke rregulluar në mënyrë ligjore dhënien e dekoratave nga Presidenti, njëkohësisht zbatohet në mënyrë të përpiktë neni 84.28 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Natyrisht, me këtë Projektligj do të plotësohet edhe një pjesë e mbetur e paplotësuar e legjislacionit tonë dhe unë shpresoj se do të ketë përkrahje të duhur që me plotësimet dhe përmirësimet procedurale, më në fund do ta kemi ligjin e miratuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër! Sipas radhës, i pari duhet ta marrë fjalën, nëse Komisioni ka mbajtur mbledhjen e saj, kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Natyrisht se fjalën do ta marrë edhe në emër të Komisionit për Legjislacion, por edhe në emër të Grupit Parlamentar dhe për dijen e anëtarëve të Kuvendit, Komisioni për Legjislacion ka hartuar një raport preliminar dhe është pajtuar që projektligji të kalojë në parim.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Projektligjin në fjalë dhe me rastin e shqyrtimit ka konstatuar se Projektligji i plotëson kriteret e përgjithshme për t'u proceduar në Kuvend.

Pasi që projektligjit iu kanë bashkëngjitur dokumentet përkatëse apo shkresat shpjeguese që janë të domosdoshme për t'u lexuar në parim, Projektligji i ka dispozitat e përgjithshme ku rregullon: qëllimin, përmbajtjen dhe dispozitat për zbatimin e projektligjit dhe, mbi të gjitha, Projektligji është i hartuar edhe duke iu përmbajtur rregullave juridike apo teknikës juridike.

Megjithatë, Grupi Parlamentar ka konstatuar se, ndoshta, është e domosdoshme që në këtë Projektligj të shikohet numri i dekoratave që është paraparë t'i ndajë Presidenti i Republikës së Kosovës. Ne konsiderojmë se është një numër tejte i lartë, domethënë, krahas numrit të banorëve që kemi, është një numër diku 28 dekorata që parashihen vetëm në këtë projektligj dhe është lënë mundësia me një nen përkatës që këto dekorata të shtohen edhe me akte të brendshme.

Prandaj, e kemi menduar edhe në Komision për këtë çështje apo për këtë projektligj të organizohet një dëgjim publik dhe pastaj do t'i marrim rekomandimet e grupeve tjera parlamentare, të deputetëve dhe në komisionin funksional të shikojmë numrin e dekoratave, përmbajtjen e këtyre dekoratave dhe pastaj t'i bëjmë rekomandime Kuvendit të Kosovës.

Në fund, konsiderojmë se Grupi Parlamentar ka dhënë mbështetje që të aprovohet sot në parim projektligji në fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sipas radhës, rendi është i shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së. Fjala i jepet deputetit Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Shumë faleminderit, zoti Kryetar!

Zëvendëskryeministri e dha arsyetimin në emër të Qeverisë për këtë projektligj, e po ashtu edhe kryetari i Komisionit funksional, zoti Hyseni. Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet në parim Projektligjin e sjellë në Parlament. Po fillon të plotësohet infrastruktura ligjore e ushtrimit apo e funksionalizimit të kompetencave të Presidentit. Nëpër grupe funksionale, sigurisht, do të mundohemi ta begatojmë, sepse propozimi sipas këtij projektligji mbulon shumë segmente të jetës në Kosovë dhe është koha që të respektohen, të nderohen dhe të lavdërohen ata që e meritojnë, po edhe rruga në të cilën do të vijë deri te një respekt i tillë.

Po qartësohet praktikisht, se Presidenti, si autoritet suprem të këtë të drejtë kushtetuese dhe besojmë që do të ketë mundësi tash përmes infrastrukturës ligjore t'i ushtrojë kompetencat. Besojmë se do të vijnë edhe segmente të tjera që janë të domosdoshme, në mënyrë që të plotësojmë infrastrukturën e plotë ligjore.

Prandaj, Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet në parim dhe besojmë që shumë shpejt do të sillet për miratim në lexim të dytë. Faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Sipas radhës, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Riza Smaka e ka kërkuar fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuari zoti Kryetar,

Ministra të nderuar,

Deputetë të respektuar,

Grupi Kuvendor i Partisë Politike Aleanca Kosova e Re, parimisht e mbështet këtë dokument dhe do të japë kontributin e vet për t'u bërë më i mirë, më i definuar sa dhe si duhet, duke i eliminuar disa diskrepanca.

Disa vërejtje parimore: Preambula duhet, medoemos, të riformulohet dhe data e preambulës duhet të precizohet se kur ky Kuvend e miraton këtë dokument?

Me dispozitën e nenit 4, sipas këtij formulacioni, del se pjesët e caktuara ligjore i konsedohen ndonjë akti nënligjor që nuk është në rregull, nuk mund të qëndrojë në rendin juridik modern. Ligji është bazament, ndërsa aktin nënligjor vetëm mund ta tejrrregullojë, po frymën e ligjit duhet ta ruajë.

Në nenin 6, alineja në vazhdim nuk është e plotë, fillon fjalia që nuk është complete. Duhet të riformulohet.

Te neni 43, e ndalon dhënien e ndonjë dekorate më të ulët për atë që e paska marrë një herë një më të lartë. Kjo nuk ka rezon, nuk është e thënë që nëse e ka marrë një dekoratë të rangut më të lartë që s'mund ta marrë më të ultë, do të ishte e kundërta, disi më tepër e logjikshme.

Me dispozitën e nenit 44, praktikisht njëjtësohet pozicioni i personit që do të ishte nën hetime me atë që paska bërë krim të rëndë, e personi që ndodhet nën hetime nuk është fajtor. Absolutisht, s' mund të merret si fajtor përderisa nuk do të miratohej aktgjykimi i formës së prerë. Pra, nëse ndokush do t'i thoshte, do t'ia hidhte se është nën hetime, do të bënte vepër penale që do të dënohej së paku 3 muaj ditë, kështu që kjo dispozitë duhet të riformulohet.

Si vërejtje parimore, Grupi Kuvendor i AKR-së ka që është numri i madh i dekoratave dhe i çmimeve. Kështu, krahasuar me disa dokumente të shteteve përreth, po e zëmë, është numër tepër i madh.

Teksti, kudo duhet të jetë në njëjës. Diku është njëjës e diku është në shumës këtu. Pra, medoemos duhet të bëhet harmonizimi tepër serioz i teksteve në: shqip, boshnjakisht, serbisht dhe në anglisht. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Gjylnaze Syla e ka fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!

I nderuar, zoti Kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për ndarjen e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës bazohet në përmbushjen e përgjegjësiave kushtetuese që ka Presidenti në dhënien e dekoratave, që është e definuar në nenin 84, paragrafi 4 i Kushtetutës. Kosova aktualisht ka nevojë për sigurimin e bazës së mirë ligjore në këtë fushë. Me këtë projektligj kryhet korniza ligjore me parimet e përgjithshme për dhënien e dekoratave shtetërore nga Presidenti, si shpërblim më i lartë shtetëror për shërbime të veçanta ose veprime me rëndësi të veçantë për Republikën e Kosovës dhe interesin kombëtar. Me një fjalë, këto dekorata u ndahen qytetarëve të Republikës së Kosovës ose qytetarëve të huaj, si dhe personave juridikë.

Projektligji definon 26 lloje të dekoratave, emërtimin e tyre, procedurën e ndarjes, propozimet për dekorim, përfshirë të shtetasve të huaj, procesin e shqyrtimit të propozimeve, përjashtimin e propozimeve që nuk i plotësojnë kushtet në rast të krimeve, të shkeljeve ligjore, të dëmtimit të reputacionit dhe të vlerës së aktit të dekorimit. Propozimet parashihen të vijnë nga Presidenti, por edhe nga udhëheqësit e institucioneve qendrore dhe lokale, strukturave të sigurisë, arsimit, gjyqësisë, prokurorisë, organizatave tjera. Në Projektligj janë futur edhe mekanizma përkatës për shqyrtimin e propozimeve, Komisioni vlerësues i cili vendimet ia përcjell Presidentit, kurse vendimin përfundimtar e merr vetë Presidenti i Republikës së Kosovës.

Megjithatë, projektligji nuk është mjaft preciz, prandaj, në vazhdim do të përqendrohem në vërejtjet kryesore dhe propozimet konkrete se çfarë duhet plotësuar në ligj.

Në nenin 2, ku është dhënë definicioni për dekorata, duhet të shtohet "se dekorata përmban edhe dokumentin i cili është publik", pra nuk mund të jepet vetëm dekorata pa një dokument.

Dy, sa i përket titullit të Projektligjit dhe ndarjes, një nen duhet të definojë se ndarja e rregullt e dekoratave duhet të bëhet, së paku, një herë në vit, dhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës propozon që kjo të bëhet në Ditën e Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt.

Megjithatë, duhet përfshirë edhe një nen tjetër që, në raste të veçanta, Presidenti bën ndarjen e dekoratave, si gjatë vizitave shtetërore, largimit të diplomatëve të akredituar në Kosovë, pasi që përfundojnë misionin ose në raste të dekorimit pas vdekjes. Për shkak të kontributit të madh dhe të meritave të jashtëzakonshme që ka diaspora, duhet të definohet e drejta e propozimeve të dekoratave edhe nga diaspora.

Nuk është e përcaktuar mënyra e mbajtjes së dekoratave, prandaj duhet cekur se kjo rregullohet me akt nënligjor. Po ashtu, duhet definuar kushtet e dhënies së dekoratave post-mortum (pas vdekjes) dhe të trashëgimisë së këtyre dekoratave nga ana e anëtarëve të familjes: gruas, fëmijëve, vëllezërve, motrave, e tjerë.

Nuk janë përfshirë dispozitat ndëshkuese në rast keqpërdorimeve, qoftë të prodhimit të paautorizuar, të shitjes së dekoratave, të bartjes, të dëmtimit ose të çështjeve të tjera të pandershme.

Duhet, gjithashtu, të parashihet revokimi i dhënies së dekoratave në rast të veprimeve kundërligjore. Në memorandumin shpjegues, zoti zëvendëskryeministër tha se është në pajtim me aquis communitaire. Zoti zëvendëskryeministër, në vetë deklaratën e pajtueshmërisë të Agjencisë për integrim pranë Zyrës së Kryeministrit, theksohet se aquis communitaire nuk rregullon çështjen e ndarjes së dekoratave, porse kjo është çështje individuale e shteteve anëtare të BE-së.

Dhe, në fund, një vërejtje shumë esenciale, e cila e vë në pikëpyetje zbatimin e këtij ligji e që ka të bëjë me shpenzimet buxhetore. Shpenzimet buxhetore janë të larta: 6.357.428 euro për periudhën prej tre muaj të vitit 2008, dhe për dy vjet, 2009 dhe 2010. Për 3 muajt e ardhshëm parashihen shpenzimet prej 879.632 euro, kurse për dy vitet e ardhshme në secilin vit nga 2.738.898 euro. Po ashtu, duhet paraparë shpenzimet shtesë për dy vitet e ardhshme nga 100.000 euro, sepse shumica e medaljeve do të jenë nga ari dhe mund të vjen edhe ndryshmi i çmimit në tregun e arit, e po ashtu edhe shpenzimet e tjera.

Nga ana tjetër, nuk ka indikacione se Presidenca do të jetë në gjendje t'i absorbojë shpenzimet brenda buxhetit të vet dhe, po ashtu, këto shpenzime nuk janë paraparë me kornizën afatmesme.

Meqenëse Projektligji nuk i ka informatat e nevojshme për zbatimin e tij, që e ka propozuar sponsori – Zyra e Kryeministrit dhe, duke u bazuar në vërejtjet që i kemi dhënë, ne nuk mund ta aprovojmë në parim ligjin në këtë formë, prandaj Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk do ta votojë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar” 7+” s’është paraqitur askush. Më falni, në emër të LDD-së, deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i LDD-së e ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për ndarjen e dekoratave nga ana e Presidentit të Republikës së Kosovës. Ne e konsiderojmë si vazhdimësi të përmbushjes së vakumit, do të thotë, me legjislacion adekuat në këtë rast për personalitetin numër një të vendit.

Në këtë kuptim, kemi disa vërejtje parimore: në nenin 2, për shembull, dhe në nenin 6, pastaj edhe sa u takon implikimeve buxhetore të zbatimit në praktikë të këtij ligji, por kontributet tona ne do t'i japim në procedurat e mëtutjeshme në komisionet funksionale. Ne në parim e mbështesim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Radha është e grupit "7+". Fjalën e ka deputeti Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ministra të nderuar,

Kolegë deputetë,

Në parim Ligjin për dekoratat e Presidentit ne e mbështesim, por ndoshta në komision, sikur që thanë kolegët, duhet të përmirësojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputeti Bojan Stojanović e ka fjalën.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke će biti uzdržana na prvom čitanju ovog zakona i naravno, smatramo da će to jednog dana doći na red. Mi ćemo sve one primedbe i sugestije koje imamo da preko funkcionalnih komisija probati da ih implementiramo. I to nikako ne znači da u konačnom usvajanju, tojest na drugom čitanju, Samostalna liberalna stranka neće podržati ovaj predlog zakona. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, radha është e deputetëve. Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Numan Balić.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Selam svima koji su prisutni! Ja sam malo protabirio ovaj zakon i mislim da je prilično obuhvatan i da sadrži dosta dobrih rješenja. Obratio bih pažnju na poglavlje III koje reguliše postupak davanja odlikovanja od Predsednika Republike i onaj dio koji se tiče inicijativa kao i prijedloga za ova odlikovanja.

U onom dijelu koji reguliše pitanje inicijativa za odlikovanja u članu 37. stiče se utisak da gotovo ekskluzivno pravo za inicijativu za odlikovanje imaju institucije. Dakle, preovladjujuće ili gotovo isključivo pravo.

U ovom članu 1.10 spominju se ličnosti iz raznih životnih oblasti i civilnog društva. Mislim da je ovo prilično skromna formulacija i da malo zanemaruje istaknute pojedince, zaslužne pojedince, ljude koji su se borili za zaslugama, potom razne ugledne organizacije, asocijacije, razna društva, civilna društva, razne zajednice, vjerske

zajednice. Znači jedan čitav spektar društveni koji bi mogao biti pokretač inicijativa. Predlažem da se ovaj dio ovoga člana promjeni da bi ovaj dio zakona koji se tiče inicijative bio potpuniji.

U narednom dijelu, koji se takodje tiče ovoga pitanja, želim da istaknem da, to je koleginica takodje rekla, vrlo važno pitanje koje nije obuhvaćeno u Zakonu o odlikovanju, jeste odlikovanje poslije smrti, odnosno post-mortum. Ima jedan veliki broj ljudi koji su se borili i koji bili žrtve prošlog režima, žrtve torture ili su bili prognani ili su bili po zatvorima i tako dalje, koji neće biti u mogućnosti da na ovaj način i ovim definisanjem budu spomenuti, izričito spomenuti u ovom zakonu. Tako da bi bilo važno da ovaj zakon u jednom svom dijelu, u jednom članu definiše pitanje odlikovanja post-mortum.

Takodje, treba voditi računa o familjama, postoje čitave familje koje su dale zaslužne ljude i koje ovde nisu spomenute, i što bi se, takodje, trebalo precizirati ovim zakonom.

Zatim, vezano za prijedloge stranog državljanina za odlikovanje. Mislim da član 39. ako hoćemo zakon da bude dobar, mora pretrpjeti izmene. Vidite kakva je kontradikcija, molim vas. Član 39. govori o prijedlogu stranog državljanina za odlikovanja. A onda se, u drugoj rečenici, kaže: „za kosovske građane van domovine“ Kosovski građani van domovine nisu strani državljani. Molim vas, to je krupna greška koja se ne bi smjela tolerisati i koja se mora promjeniti. Dakle, imamo mnogo ljudi koji su posebno u zadnja dva desetljeća, 80-tih i 90-tih godina dali, kao što sam već rekao, velike žrtve, bili žrtve torture, proganjanja i tako dalje u svim periodima, naročito krajem 80-tih i početkom 90-tih, među njima, naravno, ne samo pripadnici većinske zajednice, koji jesu apsolutni broj, nego i pripadnici i drugih zajednica - Bošnjaka i ostalih zajednica koji su u inostranstvu i koji bi mogli biti među onima koji bi trebali ili mogli biti odlikovani. Mislim da one ne treba svrstati u strane državljane.

Mislim da Ministarstvo za vanjske poslove nije u stanju da sama obavi taj posao. Pošto diaspora odnosno naši građani u inostranstvu, ima ih sada preko pola miliona, pošto su se oni odselili najmanje u dva desetljeća u dvije decenije, Ministarstvo vanjskih poslova nije u stanju to da riješi. Mislim da bi ona morala imati pomoć i drugih organizacija, asocijacija, društava i tako dalje, i tako dalje.

Zatim, oko postupka predlaganja. Preložio bih da, takodje, kod predlaganja da se apsolutni prioritet daje predstavnicima institucija. Tek, pod brojem 1.12 kaže se vrlo šturo i vrlo kratko „lice sa javnom reputacijom i druge javne organizacije“. Mislim veoma štura formulacija, gde se ponovo trebaju obuhvatiti i istaknuti pojedinci, organizacije, asocijacije, vjerska društva i tako dalje.

I, naravno, ovde bih razmislio i dao bih predlog da se razmisli, kod predlaganja. Mogućnost za predlaganje da imaju ne samo institucije, nego i ove organizacije koje sam spomenuo, već i pojedina mjesta, naselja, sela, gradovi, četvrti i tako dalje. Dakle, mjesta koja su se historijski istakla u pojedinim periodima, ne samo u zadnje nekoliko decenija, nego i u čitavom prošlom vjeku, postoje poznata mjesta, heroji, gradovi ili četvrti ili sela, heroji grada i tako dalje. To je nešto o čemu bismo mogli da razmislimo. U historiji

svakog naroda koji drži do sebe, postoje takva mesta i mislim da tome mora imati mjesta u zakonu o odlikovanjima.

Eto, uglavnom su ovo stvari koje se tiču ovoga zakona. I, naravno, da ne zaboravim oko Komisije za procjenu. Ovde naravno da apsolutnu ulogu ima Predsjednik Republike kao prvi čovek države, ali da naravno treba naći neki, da tako kažem, relativizirajući član koji bi omogućio da predsjednik bude u vezi i sa drugim institucijama, organizacijama, pojedincima, veteranima i svima onima koji su spremni i koji mogu da budu uključeni u proceduru procesa odlikovanja. Hvala vam lijepa!

KRYETARI: Faleminderit! I radhës është deputeti Emrush Xhemajli, le të përgatitet Hydajet Hyseni-Kaloshi.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Me vëmendje e kemi lexuar Ligjin dhe pajtohem me atë që e tha zoti Bahri Hyseni që të kalojë në lexim të parë. Në ligj unë kam disa vërejtje, shumë vërejtje, të cilat do t'ia përcjell komisionit gjegjës funksional për përpunim.

Megjithatë, unë nuk mund këtu të lë pa shpreh habinë time se si një dekoratë që është dhënë më herët – Medalja ose Dekorata “Jusuf Gërvalla”, këtu nuk është e përfshirë. Më herët kjo është dhënë. Për të mos e dramatizuar, unë do të thosha që “Medalja e Artë e Lirisë” duhet të emërtohet me emrin e Jusuf Gërvallës që përfaqëson gjenerata të tëra dhe dihet qysh ishte më herët. Ne e dimë që nuk e ka pasur kjo medalje bash këtë karakter më herët, por për mendimin tim, kjo do të ishte e drejtë. Kjo është një.

E dyta, Dekorata kushtuar demokracisë, për mendimin tim, ka qenë dashur të përfshihet në projektligj dhe të quhet “Ukshin Hoti”, sepse “Dekorata për Demokraci” më së miri do t'i shkonte këtij emri për shkak të vetë faktit se edhe teorikisht e ka mbrojtur më së miri dhe me jetën e vet dhe me shembullin e vet i ka shkuar deri në fund një bindjeje konsekuente që ka qenë në gjendje ta mbrojë me vetveten.

Ndërkaq, për dekoratat nuk është fjala që të lëshohen në lirim, sepse ne e dimë se dekorata jepet për një rezultat të rrallë, në një fushë të caktuar që nuk e mbërrin gjithkush. Ndërkaq, në ligj kemi, për mendimin tim, edhe aso dekorata që mund t'i mbërrijë shumë kush ose gjithkush, ose një pjesë e madhe e popullsisë i ka mbërri.

Terminologjia “me epitete” në ligj ka shumë inflacion, për mendimin tim. Për të njëjtën dekoratë përshkruhen disa epitete që përshkruhen edhe në dekoratën tjetër, ose për disa dekorata të tjera. Kjo nuk shkon. Kjo ndodh në shumë nene, sidomos në nenin 5 pika 1.6, në nenin 5 pika 1.7 dhe pika 1.8. Këtu, te dekorata e kushtuar Rugovës, kjo ose duhet të zëvendësohet me vetëm një term, si dekoratë për pacifizëm ose duhet të hiqet fare. Ndërkaq, epitetet që përdoren për humanizëm te Rugova iu kanë përshkruar Nënës Terezë dhe nuk mund në dy vende të vihet i njëjti epitete. Pastaj, për pajtim dhe për paqe i përshkruhet Anton Çetës. Do të ishte mirë që të kursehem në epitete dhe të jetë Dekorata për Pajtim “Anton Çeta” dhe mos të përzihet me epitete të tjera, që iu përshkruhen të tëra dekoratave.

Domethënë, ligji ka shumë këso lloj të metash, por po pajtohem se gjatë dëgjimit publik, gjatë konsultave të mëtutjeshme, procedimit në komisionin funksional të Kuvendit të Kosovës, në komisionin përkatës funksional, ai do të përpunohet më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit edhe prej teje! Fjalën e ka Hydajet Hyseni-Kaloshi, le të përgatitet deputeti Ardian Gjini.

HYDAJET HYSENI-KALOSHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Të nderuar ministra,

Duke ju përshëndetur, më lejoni të përshëndes nismën për miratimin e Ligjit për dekoratat, siç është thënë këtu, nga Presidenti i Kosovës. Ky ligj, për nga natyra e tij, do të duhej të ishte i saktë dhe e kam pritur një ligj vërtet që do të ishte i kursyer dhe i menduar mirë dhe shembull i akribisë juridike. Për fat të keq, nuk është. Prandaj, edhe ligjit i janë përvjedhur shumë mangësi, paqartësi dhe, do të thosha madje, edhe të natyrës së ndërtimit të tij.

Kosovës i duhet një ligj për dekoratat, por dekoratat nuk i jep vetëm presidenti, kurse që në fillim është ngatërruar edhe në nocionin. Vëni re atje te nocioni, “dekorata është” edhe pastaj fillon “dekorata, mirënjohja, urdhri” e tjera, si është. Dekorata është dekoratë dhe pastaj është edhe mirënjohje, e tjera. Prandaj do të duhej sqaruar.

Për më tepër, nuk ka një sistem, një harmoni midis asaj që janë quajtur çmime, mirënjohje, dekorata. Nuk ka as në formulime, po edhe nuk ka një koncept të qartë çka po bëjmë me të këtu, po e ndërtojmë të kaluarën apo po rregullojmë një çështje të nevojshme për njerëzit që janë?

Për të qenë më konkret, motivimi herë është në të kaluarën, për ata që kanë kontribuar, herë është në të tashmen, për ata që kontribuojnë. Diku është për ata që kanë kontribuar, por që edhe tash kontribuojnë, diku është as njëra as tjetra, por për kontribut ta zëmë dhe është më normale, më standarde. Por, nëse është në njërin njëra formë, në tjetrën tjetra formë, do të shtrohet puna si do të zbatohet në praktikë?

Janë edhe disa që u përmendën si vërejtje nga parafolësi. Për shembull, Medalja e Artë e Lirisë, thotë për kontributin e lartë në mbrojtjen e lirisë. Cilën periudhë e përfshinë kjo mbrojtja e lirisë? Po të jetë për kontributin e lartë të lirisë, ose fitoren e lirisë, e tjera, është diçka tjetër. Por, mbrojtja e lirisë vështirë ta themi edhe për sot e tutje, e lëre më për një periudhë më të hershme.

Ose Medalja “Lidhja e Prizrenit,” ka përfshirë mirëkuptimin midis komuniteteve e tjera, gjë që shumë më mirë e përfshin një medalje tjetër. Ajo për pajtim, ta zëmë, dhe tolerancë dhe do të duhej të përfshihej, thotë, “për mirëkuptim”. Ç’është mirëkuptim? Si mund t’i jepet dikujt dekoratë për mirëkuptim? Mund të jepet për tolerancë, për bashkëjetesë po pse jo - edhe për bashkëjetesë. Për “vëllazërim- bashkim” e lëmë për të kaluarën, për ata që kanë qenë rob të saj.

Ose te Medalja për Nënë Terezën është që kontribuojnë në fushën e humanizmit, por kjo do të thotë i përjashton ata që kanë kontribuar në të kaluarën. Kurse, te “Mësuesi i

Merituar” kontribut të dhënë dhe që po e japin. Vëni re! Që po e japin! Tash, si do ta zbatosh në praktikë? Ose, Medalja “Kristala Dardanika”, thotë u jepen qytetarëve të huaj që kontribuojnë për Kosovën, kurse ka një çmim atje, qytetar nderi, ka çmimi i Presidentit për merita që e absolvon këtë, por jo vetëm kaq, por thotë pastaj kristali si simbol, si ishte, në kuptimin e miqësisë.

(Ndërprerje nga regjia)

Ju faleminderit! Ndoshta edhe një minutë si propozim. Dhe, krejt përfundimisht, mendoj se këto duhet të korrigjohen, duhet të shtohet edhe” Çmimi “Jusuf Gërvalla e Kadri Zeka”, që kanë qenë për informim dhe mund të ishte për veprimtari patriotike, kështu ka qenë, dhe mendoj se e mira do të ishte që ligji të kthehet në ripunim për të mos e hallakatur ne dhe për të bërë shumë amendamente që edhe mund të ndërlikohet. Faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Faleminderit edhe prej teje! Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini, le të përgatitet Ramadan Avdiu.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar! Është kënaqësi të flasësh si deputet e jo si shef i Grupit, domethënë flet njeriu pak më sh lirë. Si shef i Grupit duhet t’i përfaqësosh të gjithë, e si deputet e përfaqësojmë vetveten në moment ose mendimin tonë. Mendoj se po e them fjalën e fundit të parën, është interesant nganjëherë. Ky është ligj, thuaja se e ka punuar një njeri i cili për një kohë nja 30 vjet ka qenë komunist i përбетuar. Me aso primesa të mëdha komuniste brenda që dikush këqyr seri dhe thotë – more, a duam të dalim ne dikur prej atij sistemi, apo duam të mbesim krejt jetën ku kemi qenë?

Qysh nuk po e merr guximin dikush nganjëherë dhe të thotë – boll bre, se këto nuk janë normale, kanë kaluar 10 vjet prej lufte. Kanë kaluar 20 vjet qysh se ka rënë Muri i Berlinit dhe ne nëpër ligjet tona tash gjejmë primesa kaq të egra komuniste që dikujt as mendja nuk ia merr. Po flasim për simbolikë, se këtu do të thotë nuk ka të bëjë me, shembull ta marrim, me reformë agrare. Mirëpo, simbolika është tepër e rëndësishme për shkak se ne simbolikën tentojmë ta shesim, t’i tregojmë dikujt sa vlej m, t’i tregojmë dikujt se çka është simbolike në Kosovë, çka është në rregull, çka është normale dhe çka na përfaqëson neve, cila është etiketa jonë? Nëse simbolika jonë është kështu, unë po ju tregoj se është tepër e gabueshme dhe unë si qytetar i Kosovës dhe si deputet ju thërras edhe juve dhe po ju lutna, mos bëni kështu gabimi.

Shikoni çka ka këtu. Këtu ka trofe të Presidentit, për shembull. Trofe të Presidentit, që dikush këqyr seri. Sportistët janë sportistë, paguhen, marrin medalje, është mirë të nderohen, por janë kushedi sa dekorata më përpara të cilat mund t’i përmbledhin këto çështje. Po flas se janë 26, po flas për disa elemente tepër banale. Ka edhe dekoratë për eksport. Domethënë, thuaja se ata njerëz që eksportojnë, janë çua në mëngjes dhe kanë thënë, dua të eksportoj unë për hir të vendit. Ata janë biznesmen, ata fitojnë dhe është mirë që fitojnë, i bëjnë nder vendit kur eksportojnë, mirëpo nuk e bëjnë ata për hir të Presidentit të Kosovës, as për hir timin, as për tuajin, as për hir të qytetarëve. Ata e bëjnë për biznes të vetin, për qëllime të veta dhe le ta bëjnë sa më shumë që të jetë e mundshme, por ku keni parë ju, sikur nëpër disa ishuj të vegjël, kur presidenti thotë dua

ta dekoroj peshkatarin më të mirë. Këto janë vërtetë..., unë nuk dua që vendi im të ketë këso farë ligjesh, domethënë – merita të eksportit.

Tjetra, janë dy dekorata tepër interesante këtu, që janë duke u përcjellë, dhe është e pabesueshme që sa kohë: “Artist i Merituar” dhe “Mësues i Merituar”. Në vend se të jepen dekorata të posaçme për artistë dhe për mësues, jepja dekoratën e lirisë, bre, nëse është i mirë dhe paguaja rrogën e mirë. Mos i jepni dekorata “Mësues i Merituar” sepse janë të shpikura prej komunistëve dhe nuk ekzistojnë diku tjetër. Nuk ekzistojnë nëpër vende normale, në vende në të cilat ne po aspirojmë të jemi pjesë, të jemi domethënë të barabartë, të njëjtë ose me t’iu përngajmë, të them ashtu. Janë domethënë elemente të një sistemi presidencial, semidiktatorial, ku presidenti edhe shpik medalje të tjera përpos këtyre që i ka. E thotë aty një paragraf ose një nen – “Presidenti mund të themelojë edhe dekorata të tjera”. Nëse Presidenti mund të themelojë dekorata, pse i kemi qitur 26 në listë, kur për shembull vendet që janë me popullsi të ngjashme me Kosovën, që kanë fituar pavarësinë shumë kohë para Kosovës, që e kanë traditën e shtetësisë shumë më të gjatë se Kosova, t’i marrim dy shembuj: Sllovenia i ka 6 dekorata të parapara me ligj. Domethënë, ta marrim shembull, Estonia i ka 8, Shqipëria i ka 10, po më thotë dikush. Përderisa Presidenti ynë e bën një listë prej 26 dekoratave, të cilat e përsërisin vetveten dhe e bën njëfarë forme gati primitive dhe pjesën simbolike të dhënies së dekoratave të Presidentit të Kosovës. Pa marrë parasysh a jeni në qeveri apo në opozitë, deputetë, ju lus, mos e votoni këtë ligj se Presidenti i takon një partie të djathtë dhe kontrolloni a është i juaji a s’është i juaji, se një president i partisë së djathtë nuk bie kësi ligji: me mësues të merituar, me artistë të merituar, me eksportues të merituar, me peshkatarë të merituar. Faleminderit!

KRYESUESI EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti Gjini. Në radhë është zoti Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Do të përpiqem që të mos i përsëris diskutimet e diskutuesve paraprak. Është evidente se ky projektligj ka bukur shumë të meta që shpresoj se gjatë punës në kohën e ndërmjetme deri në leximin e dytë do të evitohen ato të meta dhe do të bëhen përmirësime të nevojshme. Është vërtet një numër i madh i dekoratave që disa do të mund të sublimohen në një, kurse unë atë çka nuk e përmendën kolegë tjerë, domethënë, në fund të ligjit thuhet se “çdo dekoratë përcillet edhe me një shpërblim financiar”. Është mirë që në mënyrë eksplicite në ligj të rregullohet shuma deri në sa mund të shkojë, sepse të mos mbetet pastaj me akte nënligjore që të vendoset për shumën, por shuma maksimale dhe minimale të potencohet në ligj, kurse me akte nënligjore pastaj për secilën dekoratë veç e veç. Unë besoj që do të jap kontributin tim edhe në kohën e ndërmjetme deri në leximin e dytë gjatë punës nëpër komisione funksionale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Avdiu! Tani fjalën e ka zoti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritje, të nderuar ministra, që jeni këtu,
Kolegë deputetë,

Po bisedojmë për një ligj po ashtu të rëndësishëm që po kompletton pjesën e legjislacionit që ka të bëjë me Presidentin e Kosovës, një institucion po ashtu i rëndësishëm. Natyrisht, ne kemi në procedurë edhe Ligjin për Presidentin dhe i bashkëngjitem vlerësimit se duhet të kompletohet sa më shpejt kjo pjesë e legjislacionit, por para veti kemi një ligj që me vërejtjet që i dëgjuam këtu e që mendoj se shumica ishin shumë konsistente dhe përmbajtjesore, rezultoi se ligji ka mjaft mangësi dhe ne kemi tash në pikën vijuese të rendit të ditës një ligj i cili ka kaluar në lexim të parë dhe për shkak të mangësive të mëdha ka rezultuar që nuk mund të amendamentohet dhe kërkesa e komisionit përkatës është që t'i rikthehet, do të thotë, sponsoruesit për ta ridraftuar.

Mendoj se edhe këtu po ndodhë diçka. Edhe ligji për të cilin po e diskutojmë ka aq shumë të meta sa që është mirë të mendojmë të mos përsërisim gjëra të njëjta, por ta themi këtu që ligji të mos kalojë këtu për t'u ridraftuar. Kam parasysh vërejtje të shumta, thashë, përmbajtjesore, por do të ndalem vetëm te një dimension që u tha këtu dhe unë dua ta përforcoj mendimin lidhur me implikimet financiare të këtij ligji.

Kosova është shtet që është në fazën e ndërtimit, do të thotë, e ka kaluar fazën e embrionit, por veç sa është duke ecur me hapa të vet pa u mbajtur nga askush, por jo me hapa shumë të fuqishëm e të sigurt që të mund t'i qëndrojnë edhe ndonjë stuhie të vogël. E kam fjalën këtu se numri i madh i dekoratave dhe kostoja e tyre bashkë me shumat përcjellëse janë pak ngarkim i buxhetit të Kosovës në një fazë tepër delikate. Ne si shoqëri kemi kategori të qytetarëve, kategori të popullsisë shumë meritore për këtë që po e jetojmë sot dhe po e shijojmë sot, pra lirinë e vendit, për të cilat s'kemi arritur të krijojmë përkujdesje minimale, sociale, po them edhe një herë, kategori shumë të merituar që ndoshta i meritojmë këto medalje të gjitha që janë këtu. Prandaj, mendoj se duhet të rishikohet në kuptimin e zvogëlimit të numrit të dekoratave dhe shikimit të implikimeve që mund të kenë po të aprovohet ky ligj i implikimeve buxhetore që mund të ketë, sepse atëherë dalim, do të thotë, si vend që i kemi zgjidhur të gjitha probleme dhe tash po mendojmë vetëm për diçka, që është e nevojshme, por jo e domosdoshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Gashi. Tani fjalën e ka zotëri Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

U dha qëndrimi i Grupit tonë Parlamentar. Edhe unë mendoj se Kosovës i duhet një ligj për dekorata. Presidenti i Kosovës duhet ta ketë atë mundësi dhe atë nder që t'i nderojë figurat e rëndësishme të Kosovës që kanë dhënë kontribut të veçantë në lëmi të ndryshme.

Unë dëshiroj t'ju rikujtoj se Presidenti i parë i Kosovës ka ndarë dekorata të tilla dhe nuk është larg dhe s'e kemi harruar se partia që tash është në pushtet e ka sulmuar shumë vrazhdët pse e ka bërë një gjë të tillë. Duket se tash kemi një ngritje të vetëdijes politike dhe shihet nevoja që Presidenti i Kosovës, megjithatë, duhet të japë dekorata dhe është pozitive kjo. Megjithatë, shohim këtu disa gjëra që ndoshta s'mund të jenë të mira. Parashihet numër i madh i dekoratave që do të ishte një inflacion dhe krahasuar me shtetet e mëdha dhe të fuqishme, një Kosovë e vogël të ndajë kaq shumë dekorata

ndoshta edhe nuk do ta kenë një vlerë të vërtetë, siç pretendohet ta kenë me anën e këtij ligji.

Po ashtu, parashihen shuma të mëdha dhe është interesant se në materialin që e kemi marrë theksohet se kostoja shtesë buxhetore ka të bëjë me dekoratat dhe vlerësohet se në vitin 2009 dhe 2010 do të jetë numër i madh i dekoratave që do të ndahen. Domethënë, qysh tash ne e dimë se do të jetë një numër i madh dhe pyetja është pse pikërisht vitin 2009 – 2010, a lidhet kjo me zgjedhjet, a do të ketë dekorata për nevoja ditore të partive politike, e tjera, e tjera. Po ashtu, nuk do të ishte mirë, sepse ndoshta edhe ulë rëndësinë e dekoratave, e ulë atë nderimin e madh që i bëhet personit nëse gjithmonë lidhet dekorata edhe me një shumë të parave që shkojnë me dekoratën, por nga gjithë kjo që shihet nga shuma e mjeteve që parashihet të shpenzohet e shohim se do të ketë dekorata me kilogram dhe, ndoshta, kjo s'është ana e mirë e ligjit që po e aprovojmë.

Unë mendoj se të gjitha këto duhet të rishikohen në procesin e aprovimit të amendamenteve dhe të kemi një ligj që vërtet, nëse Presidenti i Kosovës jep një dekoratë, personi që e merr ta ndijë veten vërtetë shumë të nderuar me të. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Salihaj. Tani e ka radhën zoti Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje, kolegë të nderuar deputetë,

Vërtet, krijimi i një ligji apo aprovimi i një ligji që rregullon çështjen e dekoratave është kryesisht ligj që ka lidhje dhe është imanent kryesisht për republikat presidenciale. Kosova, me Kushtetutën që e ka, është një Republikë parlamentare, andaj edhe një ligj i tillë nuk është koherent as me emërtimin, as me elementet kushtetutare të Kosovës.

Në qoftë se kishim për ta pasur ne Kosovën si Republikë presidenciale, atëherë do të vinte në shprehje një ligj i karakterit të tillë. Por, meqenëse kemi Republikë parlamentare, ku në fakt Presidenti i vendit zgjidhet nga parlamenti, atëherë ishte dashur që edhe kur të nxirret ligji për dekorata dhe forma të tjera të dekorimit, të kodifikohet dhe të jetë në harmoni me vendet tjera të cilat përafësisht kanë kaluar nëpër këtë periudhë.

Sipas këtij ligji, qysh është paraparë, kjo i përgjigjet një presidenti të republikës presidenciale, që zgjidhet drejtpërdrejt, që në fakt ka hapësirë të mjaftueshme edhe për të nxjerrë dekorata vetë edhe ato që ia lejon ligji. Ndërsa, meqenëse ne kemi Republikë parlamentare, atëherë ishte dashur një ligj tjetër i cili do të kodifikojë edhe numrin e dekoratave, edhe shkallën e shpërblimeve dhe format e konsekuencave buxhetore. Ne, në qoftë se e aprovojmë këtë ligj, si është, konsekuencat buxhetore mbesin aq në një dinamikë të madhe - prej 5 milionë deri në 100 milionë. Andaj, kërkoj që, duke marrë parasysh këto mangësi dhe duke marrë parasysh që sponzoruesi, me gjasë, nuk e ka ditur a është fjala për republikë presidenciale apo parlamentare, i ka dhënë veti atë guxim të na propozojë një ligj të tillë. Në fakt, edhe pse Grupi Parlamentar në parim ishte kundër, edhe unë kam mjaft argumente dhe kisha bërë apel që mos të shkojë ky ligj në këtë formë dhe të nxirret një variant tjetër gati krejtësisht i ndryshëm nga kjo. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, Ramosaj! Në radhë është zotëri Naim Maloku, le të përgatitet zotëri Memli Krasniqi, që është i paraqituri i fundit për këtë pikë. Fjalën e ka Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Parafolësit e mi thanë shumëçka që unë desha të them. Duke marrë pjesë në këtë debat për këtë Projektligj që e kemi në shqyrtim të parë, sot më lejoni edhe të shtoj diçka. Mendoj se një kapitull i veçantë është dashur në këtë Projektligj të jetë për atë se si mbahen dhe në çfarë rastevsh dekoratat në fjalë, pastaj të mendohen rastet ekstreme kur, ndoshta, duhet t'i merret ndokujt dekorata për shkak të shkeljeve të ndryshme ose veprimeve që ai person mund t'i bëjë sa është gjallë dhe, krejt në fund, desha ta potencoj edhe një herë një çështje, çështjen e kostos buxhetore.

Në mënyrë shumë të thjeshtë i kemi skuqur sytë si Kosovë para botës të Konferencës së donatorëve për të kërkuar ndihmë. Ende jemi në fazën që kërkojmë ndihma, mbështetje financiare, qoftë edhe kur si deputetë ose komisione parlamentare shkojmë në ndonjë takim ndërkombëtar, lusim që të na i mbulojnë shpenzimet OSBE-ja, DIKAFI, e organizatat e tjera.

Kjo gjendje jona siç është, siç e ilustrova me dy tre shembuj dhe pritjet edhe në këtë vit që premtimet e donatorëve të realizohen dhe miratimi i Ligjit që vetëm për tre muaj të këtij parashih 878.000 euro, për tri vite 6.357.000 për dekorata qytetarëve të Kosovës, mendoj se nuk shkojnë bashkë këto edhe unë i ftoj deputetët që këtë Projektligj, përkundër faktit se ne duhet ta kemi një Ligj për dekorata, mos të flas edhe faktet që parashihen 26 lloje të dekoratave dhe neni tjetër, që mund të ketë edhe dekorata tjera, është një inflacion i dekoratave, shkakton inflacion të dekoratave në Kosovë, andaj unë iu lutem deputetëve që ky projektligj t'i kthehet Qeverisë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: E marrë me mend se e keni mbaruar fjalën. Ju faleminderit, zoti Maloku. Tani fjalën e ka zoti Memli Krasniqi, por do të ketë edhe folës të tjerë. Nuk është e saktë ajo që thashë pak më parë.

MEMLI KRASNIQI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra, zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Mendoj se Projektligji që kemi në shqyrtim ka një rëndësi konkrete dhe është e rëndësishme që edhe institucionalisht ne të fillojmë ta kemi një mbështetje ligjore për dhënien e dekoratave, për njohjen e veprimtarive dhe të kontributeve nga fushat e ndryshme të qytetarëve të Kosovës, apo edhe të qytetarëve të huaj që kontribuojnë apo ndihmojnë Kosovën në formë të ndryshme.

Mendoj se përveç Presidentit, është e domosdoshme që të kemi, ndoshta, një rregullativë ligjore tjetër e cila e jep mundësinë që dekoratat e ndryshme të ndahen pikë së pari nga organi më përfaqësues i qytetarëve të Kosovës, që është Kuvendi i Kosovës, por meqë po flasim për Projektligjin për Presidentin, unë i kisha disa komente konkrete. Do të mundohem të jem telegrafik për shkak të kohës.

Ta zëmë, te neni 5, ne e kemi një listë prej 26 dekoratave, por mendoj se është shumë me rëndësi që, duke u bazuar edhe te modelet e shteteve të tjera, të kemi edhe në mënyrë eksplicite të theksuar se cila është hierarkia sipas rëndësisë të këtyre dekoratave, sepse merret me mend, por nuk thuhet askund se cila është dekorata më e rëndësishme. Mendoj, se në këtë nen ose në nenin paraparak duhet të thuhet që dekoratat kanë hierarkinë këtë, këtë, këtë, sipas rëndësisë.

Kur jemi te numri, unë nuk e shoh si tepër problematike numrin e madh të dekoratave, por mendoj se nuk kemi nevojë që të kemi numër aq të madh të dekoratave, nëse kemi medalje apo shpërblime, të cilat kanë ngjashmëri ose kanë njëfarë formë përsëritjeje, për shembull, kemi në dy-tri raste dekorata që jepen për kontribute qoftë në paqe, në humanizëm, në aktivitete humanitare etj.

Po ashtu, janë disa dekorata të tjera të cilat nuk mendoj se është e arsyeshme të jepen, qoftë nga Presidenti apo në të ardhmen nga Parlamenti. Ta zëmë, çmimi për eksport ose për biznes, unë mendoj se kjo është një punë të cilën mund ta bëjë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në vit mund t'i shpërblejë eksportuesit më të mirë ose bizismenët më të mirë, por nuk kemi nevojë që të kemi çmime presidenciale, atë të nivelit shtetëror për këtë punë. Në anën tjetër, janë edhe disa çmime të cilat realisht nuk arrijnë të sqarohen për çka jepen. Është Dekorata "Kristala Dardanika", e cila, thotë, u jepet qytetarëve që kontribuojnë për Kosovën, si dekoratë që simbolizon pasuritë dhe bukuritë e Kosovës në kuptimin e miqësisë. Edhe në aspektin sintaksor nuk e kam të qartë çka do të thotë kjo edhe a është shumë e nevojshme të jepet kjo dekoratë, e ka titullin shumë të bukur, kështu po tingëllon edhe latinisht "Kristala Dardanika", por nuk ma merr mendja që nëse tingëllon bukur është e arsyeshme të jetë e përfshirë gjithsesi.

Në aspekt tjetër te nenit 34, është themelimi i titujve tjerë, ku thotë se Presidenti ka të drejtë të themelojë tituj të tjerë. Nuk ma merr mendja se është e udhës të lihet kjo krejt komplet në vullnetin e Presidentit, sepse nëse ne po e miratojmë këtë ligj, atëherë ma merr mendja që Presidentit duhet t'i mundësohet e drejta të fillojë ndonjë procedurë për dhënien e urdhrave, por jo pa kaluar në procedurë të miratimit në Parlament.

Edhe dy detaje. Është iniciativa për dekorim, do të thotë, Presidenti kënd mund ta dekorojë, është te neni 37, alineja 1.9, këtu thotë: "Iniciativë për dekorim për bashkëpunëtorin e Kabinetit të tij". Nuk e shoh të arsyeshme që Presidenti të fillojë tash t'u japë medalje asistentëve personalë, sepse krijohet kjo mundësi, ndërsa te neni 40 kush ka të drejtë të paraqitjes së propozimit, krejt janë në rregull, por pikëpyetja ime është prapë te pika 1.9, kryetari i komunës. Ne do të kemi përmbi 30 komuna, do të thotë, është një numër shumë i madh i njerëzve që ju jepet mundësia për të bërë propozime dhe, po ashtu, një definim i paqartë "personi me reputacion publik dhe organizata të tjera". Do të thotë, organizata të tjera, i bie të gjitha organizatat e tjera, person me reputacion publik është pak çështje subjektive, sepse nëse Presidenti konsideron dikë me reputacion publik në nivel të lartë, atëherë ia pranon propozimin, nëse dikë tjetër nuk e pranon, atëherë nuk ia pranon, se nuk ka reputacion.

Këto, ndoshta, janë çështje teknike, por janë shumë e rëndësishme. Nëse ky ligj shkon në procedurë të amendamentimit, duhet pasur parasysh që të jetë një ligj sa më i qartë

dhe mos të lihet hapësirë për keqinterpretim ose keqpërdorim prej kujtdo qoftë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Krasniqi, fjalën e ka zotëri Ismet Beqiri, le të përgatitet zotëri Bahri Hyseni.

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Grupi Parlamentar e tha qëndrimin LDK-së. Më lejoni t'i them vetëm dy-tri fjali.

Nevoja që ta kemi një ligj të tillë, gjegjësisht projektligj, derisa të bëhet ligj është i tillë, është shumë e qartë dhe qartëson, gjegjësisht rregullon kompetencat që i ka vet Presidenti i Kosovës. Sigurisht që e mbështesë edhe që do ta japim kontributin dhe nëpër komisione, por më lejoni të them atë që disa nga dekoratat e propozuara, jo vetëm që u bëjnë nder atyre që do t'i marrin, po do t'u bëjnë nder edhe të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe vetë shtetit të Kosovës. Po i përmendi Dekoratat me emrin e Presidentit Ibrahim Rugova, Dekoratat me emrin e Adem Jasharit, komandantit legjendar, të Nënës Terezë, të Anton Çettës, e të tjerë. Po e përsëris edhe një herë, vetëm e nderojnë cilindo që do të ketë atë privilegj ta marrë një dekoratë të tillë, po e nderon edhe vet vendin dhe popullin tonë.

Unë kam një lutje që, sigurisht ka edhe shumë emra që e meritojnë të emërtohen, gjegjësisht dekorata me emra të caktuar, por që është vështirë sepse pastaj dalim në atë që, po themi, janë shumë. Megjithatë, këtu duhet të mendojmë si institucion dhe në mënyrë reprezentative, dekoratat e tilla të kenë vërtet edhe emra që e meritojnë, siç i thashë disa prej atyre, pa i nënvlerësuar asnjë edhe nga emrat që edhe janë përmendur ndër kohë.

Unë kam një propozim që Medalja, tek neni 5, e Artë për Paqe, pika 1.6 të riformulohet. Sigurisht, kjo më vonë do të jetë çështje e procedurave dhe të quhet "Medalja për Liri dhe Demokraci – President Ibrahim Rugova". Ju faleminderit!

KRESUESI: Ju faleminderit, zotëri Beqiri!

Tani fjalën e ka zotëri Bahri Hyseni, le të përgatitet zotëri Gani Koci.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

E mora fjalën me qëllim që të qartësoj dhe kolegët deputetë, se Kushtetuta e Kosovës, në nenin 84, ku parashihen kompetencat e Presidentit, e obligon Presidentin te paragrafi 28 që të nxjerrë apo të bëjë kërkesën për nxjerrjen e këtij Ligji, që e kemi sot, me qëllim të ndarjes së dekoratave –medaljeve. Prandaj, duhet ta kemi të qartë se këto kompetenca ju kanë dhënë me Kushtetutë dhe, natyrisht, krahas kësaj ka ardhur në procedim ky Projektligj.

Sa i përket shkresës shpjeguese, deklaratës financiare, unë mendoj që kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa do të japë sqarime, sepse ato shpenzime nuk janë për dekorata, por po ia lëmë që të japë sqarime kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Hyseni! Tani fjalën e ka zotëri Gani Koci.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti Bahri që ma dhe fjalën, edhe zoti kryesues, po sinqerisht unë e mbështes dhe i përkrah të gjithë ata zëra që thanë që ky Projektligj duhet t'i rikthehet edhe njëherë propozuesit me të gjitha ato arsye të cilat i thanë bashkëfolësit këtu.

Po të marrim shembullin e Shqipërisë, ka një Ligj që i ka një 18 nene dhe ka 10 medalje ose dekorata të tilla dhe definojnë shumë qartë dhe rastet kur i jepen dhe si jepen.

Mendoj se te neni 5, ka mundësi të futen në një dekoratë, në një medalje shumë raste që janë përmendur këtu dhe nuk kemi nevojë që, ndoshta, të shkojmë tani. Para disa ditësh ishte një titull në gazetë, atje: "Medalje për të gjithë qytetarët e Kosovës" dhe, nëse është kështu, medalje për të gjithë qytetarët e Kosovës, atëherë do të ishte shumë më mirë pa emra, veç medalja (a) deri në (zh). Ne i kemi 36 shkronja të alfabetit dhe në 36 shkronja gjejmë 36 raste ose 360 mijë raste kur mund të jepen medalje, ose 3 milionë raste sa mendojmë se do të jemi një ditë këtu në Kosovë. Por kjo, po them, le t'u mbetet atyre që do të punojnë pas kësaj.

Sa i përket kostos, këtu ka një ngatërrim, ata që e lexojnë ose e kanë lexuar këtë deklaratën financiare, kostoja prej 6.357.000 euro, nuk është kosto për medalje, është kosto e funksionimit të Zyrës së Presidentit për vitet 2008 -2010. dhe vetëm për medalje diku në këtë vit janë paraparë edhe është në kornizën buxhetore për këtë vit, janë diku 133.000 euro e jo më shumë, jo 6 milionë, jo 500.000 euro, por në vitin 2009 parashihen 100.000 euro dhe në vitin 2010- 100.000 euro. Nuk ka të bëjë me miliona këtu, absolutisht. Prandaj, edhe pse nuk është futur në kornizën afatmesme të shpenzimeve të vitit 2009 dhe vitit 2010, ka një vlerësim këtu që në kursime në vija të tjera buxhetore mund të mbulohet kjo veprimtari e dhënies së dekoratave në këto vite, por unë konsideroj sinqerisht që ky Projektligj duhet të kthehet dhe të merren edhe shembuj të vendeve të tjera dhe të rasteve të tjera.

Dekoratat nuk jepen për atë se çka do të bëjë dikush nesër, por çka ka bërë dikush dje, dhe këto sipas këtij Projektligji, mund të pres unë ndonjë dekoratë për një diçka që ndoshta mund ta bëjë pas 5 vjetëve ose mbas 10 vjetëve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! E kemi edhe zotëri Gani Buçincën. Urdhëro zotëri Gani!

GANI BUÇINCA: I nderuar zotëri kryesues,

Unë iu bashkohem të gjithë atyre zërave, të cilët kërkuar që ky Ligj t'i kthehet sponsoruesit dhe të marrë mundimin sponsoruesi që t'i shqyrtojë ligjet në rajon dhe të na sjellë një ligj i cili është i aplikueshëm edhe i cili vërtet e nderon atë që e merr dekoratën, por njëkohësisht e nderon edhe atë që e jap deklaratën.

Unë mendoj se në rast se aprovohet ky Ligj, kështu siç është, Presidenti i Kosovës, nuk po flas për Presidentin aktual, por si institucion, Presidenti nuk do të ketë mundësi t'i kryej të gjitha ato obligime shtetërore që i ka, por tërë kohën do të merret duke menduar kujt duhet t'i japë një dekoratë dhe për ceremonitë e dhënies së dekoratave. Kështu që, për t'i lënë mundësi Presidentit që të merret si institucion, presidentët që do të vijnë pas 10 vjetësh, 15 vjetësh të merren edhe me ato punë e tjera që i ka si obligim

shtetëror, do të ishte mirë që të reduktohet numri i dekoratave, të bihet në një numër të arsyeshëm dhe të konsultohen pak edhe praktikant në rajon edhe të shteteve që ekzistojnë, ka shtete që ekzistojnë para nesh, nuk kemi nevojë të shpikim asgjë, se ne nuk jemi të parët që e bëjmë shtetin e Kosovës, po duhet t'i shfrytëzojmë të gjitha ato praktika. Në OKB janë 193 shtete dhe me siguri do të gjejmë një variant për një ligj i cili u përshtatet rrethanave tona, është i pranueshëm për të gjitha forcat politike dhe është i pranueshëm për të gjithë presidentët që do të vijnë pas presidentit aktual. Në rast se miratohet ky ligj, kështu si është, jam i bindur një president tjetër nuk do të ketë mundësi më shumë se dy, tri dekorata t'i ndajë për arsye se do të varet shumë nga bindjet politike të atij presidenti që do të vijë dhe nga rrethanat që krijohen dhe ky ligj do të bëhet i pavlefshëm.

Unë, besoj se në dispozitat kushtetuese aktuale që janë, janë disa të drejta të cilat qytetarët e Kosovës do t'i realizojnë më vonë. Akti më i lartë themeltar i një shteti, konstitucionalistët e dinë, është një akt dinamik, i parashikon disa të drejta të cilat, për momentin, për shkak të gjendjes ekonomike, politike e ku ta di unë tjetër, nuk mund të realizohen, mirëpo presin që të realizohen një ditë dhe prolongimi i këtij ligji nuk është shkelje e dispozitës kushtetuese për momentin, nuk është aq e ngutshme, urgjente, ta bëjmë një ligj të pranueshëm për të gjitha forcat politike këtu dhe të pranueshëm për të gjithë presidentët që do të vijnë pas presidentit aktual. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Buçinca. Është paraqitur për fjalë edhe zotëri Agim Veliu. Por, t'ia japim fjalën, ndoshta, sponsoruesit së pari, pastaj edhe Agim Velin. Besoj, shpresoj dhe uroj, madje edhe po këshilloj që të jeni të fundit. Urdhëro, Ramë

RAMË MANAJ: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Ju lutem, unë nuk do të doja ta merrja fjalën, pas këtij debati, por megjithatë me shpresë që edhe pak sqarime të bëhen, duhet të them shumë qartazi. Ky draftligj është dhënë në lexim të parë sot. Asnjë draftligj, asnjë ligj nuk mund të merret i përkryer dhe nuk ka të përkryer. Secili draftligj, madje edhe secili ligj e ka gjithmonë mundësinë e përmirësimit dhe të plotësimeve.

Nëse një draftligj që ofrohet këtu, me përmbajtjen e vet plotëson diku 70-80% të kriterëve, për një 10% të përmbajtjes nuk do të duhej kthyer, ju lutem, nuk pozicionohem për t'u kundërshtuar me individët, ndoshta po me pikëpamje.

Çështje tjetër, jo për t'u kuptuar si cikërrimtar, por vetëm për një sqarim shtesë, a është në përputhje me aquis-comunitaire, sepse nuk është në kundërshtim me te. Më tutje, mos ma merrni sugjerim, por mendoj se edhe disa nga diskutuesit e deritashëm e nxorën në fakt nevojën që draftligjet të lexohen pak më mirë, sepse me lexim më të mirë, më pak do të ketë paqartësi, dhe ndoshta më pak nevojë për debat në këtë fazë. Unë lus që Ligji të miratohet në parim dhe të plotësohet me të gjithë atë që është e nevojshme të plotësohet në procedimin e mëtutjeshëm në Komision dhe me amendamentimin në leximin e dytë, padyshim.

Nuk kam nevojë të flas, është thënë dhe është në përputhje të plotë me Kushtetutën që Presidenti i Kosovës duhet të ketë ligj për të nxjerrë dekorata, për të dhënë dekorata në

pajtueshmëri me të drejtat e tij kushtetuese dhe të bazuar në ligjin konkret. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri zëvendëskryeministër! I fundit është zotëri Agim Veliu.

AGIM VELIU: Ju faleminderit kryesues! Unë e përkrah aprovimin e këtij projektligji në parim, sepse është obligim kushtetues, mirëpo do doja që emërtimi i Ligjit të jetë në përputhje me pikën 28 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, sepse këtu askund nuk përmendet dekorata, po thotë jep medalje, mirënjohje dhe çmime në pajtim me ligjin, kështu që ne jemi të obliguar që ta aprovojmë një Ligj për mirënjohje, për çmime, për...

Nuk jam dakord me disa parafolës, të cilët edhe përmes këtij ligji bëjnë përpjekje që ta fshijnë një periudhë të caktuar kohore, por për ta ndoshta do të ishte më mirë, sepse do dukeshin nja 15 vjet më të ri. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Agim! Tani ka ardhur momenti kur mund t'i qasemi deklaratimit përmes votës. T'ju përkujtoj se të pranishëm janë 78 deputetë, kështu që kuorumi është për të marrë vendime. E lus regjinë dhe deputetët që të bëhen gati për votim dhe votojmë tash:

A ka dikush pa kartela? Kush është “për” pa kartela? Një. Kush është “kundër” pa kartela? Kush abstenon pa kartela? Atëherë më lejoni t'i shqiptoj rezultatet: 39 janë “kundër”, 30 janë “për” 9 abstenojnë. Në këtë formë, projektligji nuk ka kaluar në votimin e parë.

Meqë mbaruam me këtë pikë delikate, të shkojmë në pauzë për nja 15 minuta.

Vazhdimi i punës pas pauze

KRYESUESI: Zonja e zotërinj, mund t'ia fillojmë vazhdimin të seancës, meqë e kemi kuorumin prej 61 deputetëve, në ndërkohë shpresojmë se kanë për të ardhur edhe të tjerët.

Në rend dite është shqyrtimi i dytë i Projektligjit për amët. Mirëpo, unë besoj se ndoshta kryetari i Komisionit, zotëri Rustem Mustafa ka për të thënë diçka lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Urdhëroni, zotëri Rustem!

RRUSTEM MUSATAFA: I nderuari kryesues, Në Komisionin për Siguri ky ligj ka ardhur dhe Komisioni e ka prezantuar në Kuvend, ka kaluar në lexim të parë. Pas leximit të parë, Komisioni e ka bërë punën e vet dhe ka thirr tubim shqyrtues, ku ka marrë disa propozime. Pas kësaj seance dëgjimore, e kemi bërë edhe një punëtori, si sponzorues ka qenë UNDP. Të gjithë anëtarët e Komisionit jemi pajtuar që t'ia kthejmë Ligjin sponzoruesit. Kemi marrëveshje edhe me Qeverinë.

Ligji është ai që ka mbetur, nuk ka ndërrime të mëdha në të, por struktura e ligjit ka ndryshuar në disa pikëpamje, për të cilat ne jemi pajtuar në Komision, edhe për hir të

harmonizimit me ligjet e tjera që kanë të bëjnë me këtë fushë, ne jemi pajtuar të gjithë që t'ia kthejmë ligjin sponzoruesit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zotëri Mustafa! E kemi të paraqitur zotëri Gani Gecin për fjalë.

GANI GECI: Faleminderit, zoti Kryetar! I nderuar kryesues, me fal kryetar se u habita, ndoshta ke dëshirë!

Të nderuar deputetë, Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri pranë Parlamentit të Kosovës e ka pranuar një ligj të sponzoruar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Ne kemi punuar në atë ligj si Komision dhe e kemi proceduar në Kuvend, e kemi miratuar në lexim të parë, siç tha edhe zoti kryetar. Dikush tjetër nuk e ka pranuar atë ligj dhe prapë është organizuar një punëtori prej 2 deri më 5 shtator në Burim të Istogut, dhe ne si Komision Parlamentar kemi parë se Ligji që ka ardhur në Kuvend ka qenë një ligj tjetër dhe i ndryshëm nga ai ligji që e ka sponzoruar Qeveria e Republikës së Kosovës apo Ministria e Punëve të Brendshme.

Ne edhe kemi filluar të mësohemi me këtë koalicionin e juaj qeveritar, që sot thoni po, e nesër ndryshon, kemi filluar të mësohemi. U mësuam tash më qysh edhe Kryetari i Kuvendit, të martën tha që duhet të zgjidhet ombudspersoni, ndërsa të enjten tha që nuk duhet të zgjidhet ombudspersoni dhe ne jemi mësuar me këtë koalicion, prandaj jemi që t'ia kthejmë këtë ligj Qeverisë dhe të mendojë pak më mirë që ligjet tjera t'i harmonizojë me ligjet në fuqi dhe në të kemi për çka të votojmë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zotëri Geci! Ju lutem, e dëgjuat ju kryetarin e Komisionit dhe e dëgjuat gjithashtu dëshminë e tij se ka marrëveshje me Qeverinë, kështu që më lejoni ta marr guximin t'ju sugjeroj që mos të bëjmë shumë debate për këtë çështje, por t'i qasemi votimit, por megjithatë janë paraqitur deri te ky sugjerim i imi i famshëm edhe disa, zotëri Shkubimi, zotëri Lutfi Haziri, zotëri Zafir Berisha. Fjalën e ka zotëri Shkumbim Demalijaj.

SHKUMBIM DEMALIJAJ: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ashtu siç e tha edhe kryetari i Komisionit, Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri e ka shqyrtuar Projektligjin. Neve, kur ka ardhur Ligji në lexim të parë në Kuvend edhe është aprovuar, të gjithë e kemi lavdëruar edhe sponzoruesin, por edhe Projektligjin edhe më së të nevojshëm. Dallon një alibi më e fuqishme për shkak se është biseduar edhe në Kuvend, edhe në praktikën e përgjithshme se ky Projektligj, me rastin e bërjes ligj, ndërtimit si ligj, do të ndihmojë në çarmatosjen e qytetarëve, mirëpo këtu rezultoi e kundërta, sepse ky i legalizon përdorimin, mbajtjen dhe posedimin e armëve, kështu që bashkë me Komisionin edhe në punëtorinë e organizuar, që vlen të theksohet edhe një herë dhe të falënderohet shumë UNDP-i, neve nuk kemi ndryshuar diçka nga esenca e Projektligjit, mirëpo këtë marrëveshje e kemi arritur të gjithë me konsensus të përbashkët që t'i kthehet sponzoruesit për shkak se shumë elemente esenciale që i kanë munguar projektligjit, ju kanë shtuar në rastin e punës së përbashkët që kemi bërë si komision në këtë punëtori dhe i kemi kthyer sponzoruesit Projektligjin.

Është bërë praktikë e keqe në kthimin e kësaj, mirëpo besojmë se me nxjerrjen e Rregullores së re, të Rregullores së Punës nga Kuvendi, shpresojmë se në atë Rregullore të përfshihet që ligjet para se të vijnë në shqyrtimin e parë në Kuvend, t'i shqyrtojnë njëherë komisionet funksionale, pastaj të mos kemi këso përvojash të këqija që të rikthehen, por është më se e nevojshme për shkak se kemi punuar që ky Ligj të jetë i ndërtuar mirë dhe të jetë i implementueshëm dhe lehtë i ekzekutueshëm. Ne si Grup Parlamentar e përkrahim kthimin te sponzoruesi, që për një kohë shumë të shpejtë të vijë, sepse është i përpunuar mirë, do të mbesin disa çështje teknike që të finalizohen në te edhe të kalojë ky Projektligj. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYETARI: Ju faleminderit, zotëri Demalijaj!
Në radhë është zotëri Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit Kryetar! Nuk desha asgjë tjetër të them, pos ta mbështesë rekomandimin e Komisionit edhe kërkesën tuaj. Ekzakt, desha ta them atë çka e thatë ju, që të mos zgjatemi kur komisioni funksional kërkon diçka në marrëveshje ose si vendim, ne duhet ta mbështesim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka zotëri Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Ju faleminderit, zotëri kryesues!
Unë prita, realisht, pas kryetarit të Komisionit t'ua jepni fjalën përfaqësuesve të grupeve parlamentare për t'u deklaruar, por megjithatë pasi jam anëtar i atij Komisioni bashkë me ju, zotëri kryesues, ju e dini se realisht Ligji në punëtori ka pësuar shumë ndërhyrje nga angazhimet që kanë pasur anëtarët e Komisionit dhe grupet e interesit që lidhen me atë ligj dhe realisht ka qenë qëndrim unanim i të gjithë subjekteve politike në Komisionin për Siguri që ky ligj të rikthehet edhe njëherë, me shpresën që prej një afat sa më të shkurtër të kthehet në Parlament për miratim sepse, natyrisht, është ide e të gjithëve, edhe në Komision, besoj edhe e kolegëve në Parlament, se ky Ligj i duhet shumë Kosovës. Dhe, si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike, ne e mbështesim tërheqjen e Ligjit, do me thënë tek sponzoruesit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Berisha!
Meqë nuk ka të tjerë të paraqitur për fjalë, të tjerë deputetë dhe deputete, më lejoni që të marr guximin ta qesë në votim, përkundër kësaj që nuk ua dhashë fjalën shfave të grupeve, sepse e kemi deklarimin e Kryetarit të Komisionit dhe marrëveshjen me Qeverinë.

Atëherë, lus regjinë edhe juve të dashur deputetë dhe deputete, që të bëheni gati për votim.

Kush është për propozimin që t'i rikthehet në rihartim dhe riprocedim sponzoruesit ky Projektligj?

Ka përfunduar votimi. Më lejoni t'ua kumtoj rezultatin: 61 janë për këtë propozim, 3 janë kundër dhe asnjë nuk ka abstenuar. Do të thotë, miratohet propozimi dhe në fakt marrëveshja që kryetari i Komisionit e ka bërë me Qeverinë dhe Qeverisë i kthehet në riprocedim dhe rihartim ky Projektligj. Ju faleminderit shumë!

Kalojmë pa humbur kohën tuaj të çmuar te pika tjetër e rendit të ditës, e gjashta, ose e pesta,

**- Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit ad-hoc për
përzgjedhjen e anëtarëve në Këshillin e Komisionit të Pavarur
për Media**

Bazuar në përfundimin e Kryesisë, më 16 shtator të këtij viti, është kërkuar nga partitë politike të përfaqësuara në këtë Kuvend që të propozojnë nga një anëtar për formimin e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e katër anëtarëve në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media.

Ndërkohë, disa nga partitë politike të përfaqësuara në Kuvend, i kanë propozuar kandidatë e tyre për anëtar për formimin e këtij komisioni. Ftoj përfaqësuesit e partive që tani t'i propozojnë emrat.

Partia Demokratike e ka dhënë zotëri Berat Luzhën,
Lidhja Demokratike e ka propozuar zotëri Armend Zemaj,
Aleanca Kosova e Re ka propozuar, kuptojeni që nuk e kemi emrin e zotëri Ibrahim Makollit. Fjalën e ka zotëri Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Të nderuar kolegë,

Është e vërtetë që Grupi Parlamentar i AKR-së nuk e ka ofruar ndonjë emër në këtë Komision për arsye se nuk kemi marrë kërkesë zyrtare me shkrim nga ana e Kryesisë së Kuvendit dhe do të shfrytëzoj këtë rast edhe njëherë që të kërkoj nga Kryesia e Kuvendit, që në raste të tilla të dorëzohen, ashtu siç parashihet me Rregullore, kërkesat sa i përket çështjeve të natyrës së tillë.

Përndryshe, Grupi Parlamentar i AKR-së, në këtë Komision delegon, zotëri Esat Brajshori.

KRYESUESI: Esat Brajshori. Ju faleminderit shumë, zotëri Ibrahim!

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e ka propozuar zotëri Rasim Sylejmanaj,

Lidhja Demokratike e Dardanisë, zonjën Synavere Rysha.

Partia Demokratike Turke e Kosovës nuk e ka një të propozuar këtu, ftoheni që ta propozoni publikisht. Nuk është askush, atëherë me keqardhje na mbetet zbrastë.

SLS-ja ka propozuar zotëriun Dragisha Miriq.

Koalicioni VAKAT, nuk kemi ndonjë propozim. Urdhëro, urdhëro zotëri i nderuari Haxhi!

ZYLFI MERXHA: Zotëri i nderuar kryesues, në emër të VAKAT-it unë kisha për ta propozuar zotëri Sadik Idrizin, kurse në emër të turqve Myfera Shinik, në emër Partisë Rome, Haxhi Merxhen, se unë vetëm jam, për hasret.

KRYESUESI: Mirë Haxhi, ju faleminderit! Është një rekord me propozime, do të thotë një njeri tri propozime, por sidoqoftë mirë, në qoftë se nuk kemi...

Tani në radhë është SDSK, nuk ka.

SDA-ja, e keni, zotëri Numan Baliq, e keni dhënë emrin.

ND-ja, Partia Rome e Bashkuar, veç e tha zotëri Haxhiu.

IRDK-ja, zotëri Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Pasi që jam i vetmi deputetë nga IRDK-ja, andaj po e propozoj vetveten, Xhevdet Neziraj.

KRYESUESI: Okej, e shkruajmë, e evidentojmë. Ju faleminderit shumë!

SNS-ja, nuk ka.

SKMS-ja, nuk ka.

GIG – nuk ka, më falni GIG, jepjani mikrofonin Mursel Halilit.

MMURSEL HALITI: Poštovani predsjedice, GIG nema kandidata.

KRYESUESI: vetë, do të thotë, ju e kandidoni vetveten. Okej, Ju faleminderit shumë!

PDAK e ka propozuar zonjën Hafize Hajdinin.

Në këtë mënyrë kompletohet ky...

Po, njoftohen ata që nuk i kanë dhënë emrat, partitë që në ndërkohë t'i dërgojnë emrat e tyre. Disa subjekte veç e kanë paralajmëruar se në ndërkohë do ti bien. Para se t'i qasemi votimit, e kemi të paraqitur për fjalë, zotëri Xhavit Halitin. Zotëri Xhavit!

XHAVIT HALITI: Zotëri kryesues,

Të nderuar deputetë,

Ne i kemi shprehur shqetësimet tona disa here lidhur me rregullat që janë për t'u zgjedhë Komisioni ad-hoc për Media. Mendoj që në start është bërë gabim kur është paraparë që të gjitha subjektet politike të kenë përfaqësuesit në këtë komision. Do të dëshiroja që të kemi një unison të gjitha grupet aktuale politike në Parlament, dhe ato që të vijnë, që të përfaqësuara në të ardhmen në këtë Komision të jenë grupet parlamentare dhe jo partitë politike, sepse po bëhen shumë dhe realisht mundësia e funksionimit ose të funksionalizimit të këtij komisioni, është e pamundur, një, dhe dy, barazimi i një subjekti që mund ta ketë një deputet në Kuvendin e Kosovës, me një subjekt që mund i ketë 30 e 40 deputetë, është e palogjikshme. Pra, mendoj se do të duhej që rregullat të cilat parashihen të ndryshojnë në të ardhmen, me qëllim që ta ndryshojmë praktikën e deritashme.

Prandaj, qëllimi im është që t'i lus edhe grupet tjera parlamentare që vërtet ta shohin seriozisht këtë çështje dhe ta ndryshojnë, do të thotë kjo bëhet me procedurë në të ardhmen dhe e di se nuk bëhet sot, por kemi kohë që ta rregullojmë. Diçka që funksionon më mirë, më mirë është ta bëjmë ne, se sa të na sugjerojnë të tjerët. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Haliti!
Për fjalë është paraqitur deputeti Zef Morina.

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Unë nuk desha ta marrë fjalën, por meqë zotëri Haliti e potencoi një çështje që vërtet është plotësisht e drejtë, atëherë unë kërkoj që në këtë grup të jetë edhe nga Partia Demokristiane për Integrim pasi që janë të gjitha partitë që përfaqësohen në Parlament.

Unë jam pjesë e koalicionit me LDK-në, por jam parti në vete, kështu që dëshiroj që në këtë grup, në këtë Komision të jetë edhe një anëtar i partisë time. Besoj që është e drejtë.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Morina!
Propozimi i Kryesisë edhe projektimi i saj ka qenë ky që e kemi ofruar këtu. Unë po shoh edhe të tjerët, përfaqësues të subjekteve që u paraqitën, por unë për vete nuk do të guxoj, të them, se do të mund të ndërrohet kjo në këtë Parlament.

Zonja Kaqusha Jashari e ka fjalën.

KAQUSHA JASHARI: Te rregulla, vetëm në fillim e pash që edhe përfaqësimi i një deputeti hyn në këtë Komision. Ne jemi përnjëmend në koalicion me PDK-në, vetëm le të shqyrtohet kjo Rregullore, dhe unë mendoj se zoti Xhavit ka pasur të drejtë, se funksionimi prej 30 anëtarë të një Komisioni, nuk është dhe nuk mund të jetë ad-hoc. Prandaj, le të shikohet, në qoftë se përfaqësimi është kështu qysh ka filluar, edhe ne kërkojmë përfaqësimin tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Mirë, ju faleminderit shumë zonja Jashari!
Zoti Emrush Xhemajli e ka fjalën!

EMRUSH XHEMAJLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Nuk ka çka t'i shtojë asaj që u tha, le të krijohen rregulla unike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Zonja Edita Tahiri e ka fjalën!

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Unë mendoj se kjo që e propozoi zoti Haliti, ka logjikë, do me thënë që të përfaqësohen përmes grupeve parlamentare, mirëpo në qoftë se mbetet kështu me partitë, atëherë edhe Alternativa Demokratike e Kosovës kërkon pjesëmarrjen e saj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Tahiri!

Edhe i fundit është zotëri Ibrahim Makolli!

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, ju faleminderit, zoti kryesues!

Seriozisht, pak më herët Kryetari i Kuvendit tha që duhet t'ia ruajmë dinjitetin këtij institucioni.

Seriozisht, nganjëherë njeriu nuk mund ta kuptojë nëse ne jemi këtu për të vendosur ashtu sipas dëshirave tona. Subjektet politike që janë pjesë e koalicioneve, me gjithë respektin që kemi për ta, kanë hyrë në zgjedhje si pjesë e një subjekti, një koalicioni, prandaj nuk mund të kërkojnë, sepse është shumë joserioze tashmë përfaqësimi i secilit subjekt veç e veç. Madje, është një rregull, sepse kjo është një Rregullore e Punës së Kuvendit që subjektet politike brenda Kuvendit përfaqësohen përmes grupeve parlamentare dhe të mos e devalvojmë këtë çështje deri në fund, tashmë të ketë kërkesa nga secili subjekt politik që ka qenë pjesë në zgjedhje e një koalicioni. Pra, kërkesa ime është që të shkohet sipas logjikës që grupet parlamentare të propozojnë nga një anëtar në këtë komision, e jo subjektet politike, ashtu siç po pretendohet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Makolli!

Tani, më lejoni t'i qasemi votimit, por votimi do të përfshijë edhe ato propozime që nuk janë përmbushur. Unë po kërkoj falje, me të vërtetë, mirëpo propozimi që ka ardhur këtu, është bërë në bazë të dispozitave ligjore. Unë po pajtohem me zotëri Xhavitin se është temë për debat, por tani për tani është ofrue në bazë të atyre dispozitave ekzistuese.

Prandaj, ju lus që të bëheni gati ta votoni këtë propozim me atë plotësimin eventual të subjekteve që nuk i kanë dhënë emrat, pra kjo nënkuptohet, dhe lus regjinë dhe juve që të bëheni gati për, ose kundër, ose abstenim.

Votojmë, tash:

Po ua kumtoj rezultatet: 48 janë "për", 8 janë "kundër" dhe 9 kanë abstenuar. Në këtë mënyrë, kalon propozimi i sapo shqyrtuar në rendin e ditës. Ju faleminderit shumë!

Shkojmë në pikën e fundit të rendit të ditës. Pika e fundit që e kemi miratuar bashkë këtu, është:

**- Shqyrtimi i Propozimvendimit për ndarjen e mjeteve
financiare për Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës**

Meqë e kemi ministrin këtu, me kënaqësi po ia japim fjalën për ta arsyetuar, ose po ju kërkoj falje, kryetarin e Komisionit, megjithëse ndoshta do të ishte më... Urdhëroni, zotëri! Zotëri Koci e ka fjalën.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ne si Komision kemi pasur një kërkesë më 9 shtator për ndarjen e 1 milion eurove për Ministrinë e Forcës e të Sigurisë nga linja buxhetore, e ashtuquajtur Fondi për implementimin e statusit. Kërkesa është bërë nga Kryeministria dhe ne si Komision kemi pas kërkuar që kjo kërkesë të ushtrohet në bazë të normave të Ligjit mbi buxhetin për vitin 2008, të dispozitës 8.2. Ministria e Forcës dhe Sigurisë ka kompletuar të gjithë

dokumentacionin në bazë të kësaj dispozite të Ligjit dhe Komisioni, në mbledhjen e djeshme që e ka mbajtur, ka miratuar kërkesën Ministrisë së Forcës e Sigurisë me një ndryshim, sepse kërkesa e parë ishte në vlerën prej 1 (një) milion euro, ndërsa tash pas kompletimit të dokumentacionit dhe detajizimit të kërkesave, kemi një shumë më të vogël se 1 milion euro, do të thotë është 745.000 euro për këtë pjesë të vitit fiskal që ka mbetur dhe konsideroj se duhet të miratohet, në mënyrë që kjo ministri ta vazhdojë aktivitetin e vet të nisur tash.

Rekomandimet i keni marrë dhe nuk dua të shtoj, keni marrë edhe të gjithë dokumentacionin e duhur. Prandaj, kërkoj që Kuvendi ta mbështesë këtë rekomandim të Komisionit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Koci!

Duke i kërkuar falje edhe një herë ministrit, tani po ia japim fjalën. Urdhëroni zotëri Fehmi Mujota.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë që sot të bashkëbisedoj me ju për çështjen e buxhetit për vitin 2008, përkatësisht për muajin shtator - dhjetor 2008, dhe njëkohësisht e falënderoj Komisionin për Buxhet dhe Financa që na e bëri të mundur që në procedurë të përsheptuar ta shqyrtojmë kërkesën tonë, njëherësh na ka mundësuar që të jemi më të saktë për të parashikuar shpenzimet për pjesën e mbetur të vitit.

Mendoj se kemi bërë një veprim të duhur edhe si Parlament, edhe si Qeveri, në këtë rast edhe si Ministri, meqë kërkesat tona tani janë për 745.000 euro e jo për 1 milion euro sa kishin dalë nga Qeveria, në bazë të atij buxheti që është paraparë për ministrinë e ngritura fillimisht.

Unë dua të shtoj një mendim, që besoj dikush nga deputetët e ka ngritur në vija jo krejt zyrtare. Ka një linjë buxhetore që parashikon shpenzimet pak më të rritura për shërbimet komunale, por dua t'ju garantoj se bëhet fjalë për mendimin se ne mund të kalojmë shpejt në një ndërtesë tjetër dhe jo aty ku jemi, prandaj parashikimi ynë është ky.

Nuk jemi shumë të sigurt që mund t'i shpenzojmë të gjitha këto mjete mbi bazën e procedurave aktuale të Ligjit për financat, por do të bëjmë përpjekje që të jemi sa më racional dhe sa më të saktë në shpenzime. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri ministër!

Në radhë do të duhej deklaruar shëfat e grupeve parlamentare në qoftë se ndonjëri prej jush dëshiron patjetër të flasë, unë nuk po shohë të gatshëm, por e kemi zotëri Shkumbin Demaliaj dhe Ardianin të paraqitur.

Ardiani hoqi dorë. Zotëri Shkumbin? Zotëri Shkumbini e ka fjalën!

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ne, si anëtarë të Komisionit për Buxhet dhe Financa, e kemi shqyrtuar kërkesën e Ministrisë të Forcës së Sigurisë, e kemi kaluar proceduralisht, ka shkelje procedurale, mirëpo duke e parë si nevojë emergjente, e kemi thënë edhe dje në Komision, se me emocion e shikojmë ndërtimin edhe implementimin ligjeve të kësaj ministrie, por e kemi kaluar, e përkrahim dhe e përgëzojmë ministrin për planifikimin që ka bërë, sepse ne gjatë interpelancës për ministrin e Punëve të Jashtme, i kemi ndarë po në këtë formë me emocion 1 milion euro dhe thoshte nuk kemi pasur kushte logjistike.

Besoj se ministri i Forcës dhe i Sigurisë ka kushte logjistike dhe do t'i implementojë ekzekutimin e këtyre mjeteve financiare. Ju faleminderit shumë!

KRYEUSESI: Ju faleminderit, zotëri Shkumbin!

Atëherë, meqë nuk ka të tjerë deputetë ose deputete të paraqitura, më lejoni t'i qasemi votimit dhe e lus regjinë edhe juve që të bëheni gati, tash:

Është mbyllur votimi dhe po ua kumtoj se 68 vota janë “për”, asnjë kundër, asnjë abstenim. Në këtë mënyrë, njëzëri them se është miratuar vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Ministrinë e Forcës të Sigurisë.

Me kaq përfundojmë këtë seancë. Shihemi në seancat e tjera.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve